

Në fjalinë: Teuta kishte me vete një libër.	Fjala libër, është emër:
Nga fjalët e mëposhtme emër abstrakt është:	
Në fjalinë: Peshkatarin peshkon në liqen.	Fjala që tregon veprim është?
Në fjalinë: Blerta këndon në korin e shkollës.	Folja këndon, është përdorur në kohën:
Në fjalinë: Albana do të bëhet një pianiste e shkëlqyer. – folja <i>do të bëhet</i> , është përdorur në kohën:	
Në fjalinë: Dhelpra dinake sillej çdo ditë rrotull pulave.	Fjala, dinake, është :
Nga fjalët e dhëna, mbiemër është:	
Në fjalinë :Genta është një vajzë shembullore dhe besnike.	Fjalët : <i>shembullore dhe besnike janë</i> :
Kemi fjalët që shkruhen njëjloj dhe kanë tingëllim të ngjashëm, por ndryshojnë nga kuptimi i tyre, si p.sh.: - <i>veshi (organ i degjimit) dhe</i> - <i>veshi (veshi rroba e reja)</i>	Këto ndryshe quhen:
Fjalët e dhëna më posht kanë kuptim të kundërt. I gjatë – I shkurtër	Si quhen ato?
Fjala që ndryshon formën nga fjalët e dhëna është:	
Ç'pjesë të ligjëratës janë : <i>mbiemri, folja, përemri dhe emri</i> :	
Lexo fjalitë dhe përgjigju pyetjes Jetoni është djalë i mençur. Ai luan në violinë.	Cila nga fjalët që formojnë fjalitë është përemër:
Fjalja: Besa vraponte me shoqet.	është fjali:
Fjalja: Arlinda pushonte afër dritares dhe shikonte se si shiu ujiste tokën.	është fjali:
Fjali dëftore nga fjalitë e dhëna është:	
Shenja e pikësimit që duhet vendosur në fjalinë:	Gëzuar ditëlindjen - është:
Emri i personit i shkruar saktë është:	
Cila shenjë e pikësimit duhet të vendoset në fund të fjalisë:	Cili ishte ai djalë
Gjatë marrjes dhe dhënies së informacioneve në mënyra të ndryshme përdorim:	
Në fjalinë: Bekimi rrugaç, rrugëtonte çdo ditë nëpër rrugë.	Fjala, rrugë, është përdorur në forma të ndryshme. Cila nga ato është emër:
Në fjalinë : Fjolla zemërbardha ushqimin e saj e ndau me shoqen.	Fjala, zemërbardha, është:

<p>Në fjalinë: Drinit shtatlartë kostumi i rrinte bukur.</p> <p style="text-align: center;">Çka tregon fjala, shtatlartë :</p>
<p>Në fjalinë: Deti kaltrosh me dallgët e larta të tij dukej nga larg.</p> <p style="text-align: center;">Dy mbiemrat në fjalinë e dhënë janë :</p>
<p>Fjalja: Parku i qytetit tonë është i mbushur plot me lule, të cilat na kënaqin me aromën e këndshme.</p> <p style="text-align: center;">është fjali:</p>
<p style="text-align: center;">Cila nga fjalitë e poshtëshënuara është fjali e thjeshtë:</p>
<p>Sa kallëzues ka në fjalinë e dhënë:</p> <p style="text-align: center;">Nëna e Vjollcës nuk punon më, pasi shkolla u mbyll dhe tani është e vetmuar.</p>
<p style="text-align: center;">Fjalët e dhëna në marrëdhënie antonimike janë:</p>
<p style="text-align: center;">Fjalët në marrëdhënie sinonimike janë:</p>
<p>Fjalët: Ndrçimi – emër mashkulli dhe Ndrçimi – për ndrçimin e rrugëve</p> <p style="text-align: center;">kanë formë të njëjtë por kuptim të ndryshëm. Këto fjalë janë:</p>
<p style="text-align: center;">Cila fjali është shkruar sipas rregullave të drejtshkrimit :</p>
<p style="text-align: center;">Data e shënuar drejt është:</p>
<p style="text-align: center;">Cila nga datat e poshtëshënuara është shënuar drejt:</p>
<p style="text-align: center;">Shenja e pikësimit është përdorur drejt në fjalinë:</p>
<p>Çfarë funksioni kryen fjala, Besnik – besnik, në fjalitë e mëposhtme:</p> <p style="text-align: center;">Besnik, a e lexove romanin?</p> <p style="text-align: center;">Fatosi besnik qëndroi deri në fund.</p>
<p style="text-align: center;">Folja në fjali përdoret në kohë të ndryshme. Në cilën nga fjalitë e dhëna, folja është përdorur në kohën e tashme:</p>
<p style="text-align: center;">Në cilën nga fjalitë e dhëna më poshtë folja është përdorur në kohën e shkuar:</p>
<p>Në cilën kohë është përdorur folja në fjalinë e dhënë:</p> <p style="text-align: center;">Vigani do të perfaqësoj shkollën në garat shtetërore për informatikë.</p>
<p>Fjalja: - Nënë a do të më shpërblesh për punën e bërë? – e pyeti Vesa nënën e saj.</p> <p style="text-align: center;">Në ligjëratën e zhdrejtë do të ishte:</p>
<p>Fjalja: Gjyshja i thoshte Nitës që të marrë me vete edhe topin për në ekskursion.</p> <p style="text-align: center;">Në ligjëratën e drejtë do të ishte:</p>
<p style="text-align: center;">Gjatë përdorimit në fjali ka fjalë që ndryshojnë formën dhe ka që nuk e ndryshojnë. Cili grup nga fjalët e dhëna janë të gjitha të pandryshueshme:</p>
<p style="text-align: center;">Kemi fjalë që gjatë përdorimit të tyre në fjali e ndryshojnë formën. Cili grup fjalësh të dhëna janë të gjitha të ndryshueshme:</p>
<p style="text-align: center;">Cila fjali është shënuar pa gabime drejtshkrimore?</p>
<p style="text-align: center;">Cila nga datat e poshtëshënuara është shënuar drejt:</p>

Njëri nga grupet e mëposhtme përbëhet nga të trija fjalët të cilat ndryshojnë formën Cili është ai grup?
Fjalja: Kreshnik a e lexove lektyrën?- pyeti Bardhi Në ligjëratën e zhdrejtë do të ishte:
Në fjalitë: - Ju luani bashkë me ne. - Luani është djalë shembullor. Fjalët: luani, Luanitregojnë:
Foljet në fjali përdoren në kohë të ndryshme. Në cilët nga fjalitë e dhëna folja është përdorur në kohën e tashme:
Nga çiftet me mbiemrat e dhënë, çifti me mbiemra marrëdhëniorë është:
Lexo fjalinë dhe përcakto sa mbiemra përmban ajo. Fjalja: Ermali është djalë i këtushëm dhe besnik prandaj duhet të kini besim në të.
Në fjalinë: Syarta syartë është shoqe zemërmirë dhe e vyeshme. Fjalët: Syarta, syartë - si përbërës të fjalisë janë (paraqesin):
Në fjalitë: - Në verë bën nxehtë - Në dimër bën ftohtë. Fjalët: nxehtë – ftohtë, sipas kuptimit janë:
Në fjali të ndryshme ka fjalë që shkruhen njësoj por ndryshojnë sipas kuptimit si në fjalitë: - Flamuri është djalë trim. - Flamuri (simbol që bashkon kombin). Fjalëve të këtilla ju themi:
Cila nga fjalitë e dhëna është shkruar pa gabime drejtshkrimore:
Lloji letrar ku përshkruhet gjendja shpirtërore e autorit, mendimet dhe ndjenjat e tij, është:
Kur në veprat letrare ndeshim kafshë të cilët flasin si njerëzit me njëri-tjetrin, atëherë themi se kemi të bëjmë me:
Poezinë në të cilën poeti kritikon dhe përqesh të metat e një njeriu ose të mbarë shoqërisë, e quajmë:
Nëqoftëse një person lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur si dhe respekton ritmin dhe shenjat e pikësimit, atëherë ai ka bërë një lexim:
Vepra e gjatë letrare e shkruar në prozë ku pasqyrohen ngjarje a dukuri nga jeta shoqërore, themi se është:
Persona të caktuar kanë role të caktuar brenda një veprë letrare. Këta ndryshe quhen:
Me fund të hidhur përfundon vepra dramatike:
Lloji i veprës letrare ku nëpërmjet rrëfimit pasqyrohen ngjarje, njerëz që kanë marrë pjesë në to, sjelljet dhe emocionet e tyre në rrethana të ndryshme, themi se kemi të bëjmë me:
Shkaku, arsyeja, nxitja apo ngacmimi që e ka shtyrë shkrimtarin për të shkruar një vepër, ndryshe quhet:
Vargjet e mëposhtme në të cilat poeti i këndon heroit kombëtar, i përkasin poezisë: Kush nuk e di Skënderbenë Që nderojti mëmëdhenë?...

Dhe sot nga armët e tija	Kullon vetë trimëria!
Nëqoftëse një personazh bisedon me vetveten dhe shpreh mendimet dhe ndjenjat e tij për vete ose të tjerët themi se kemi të bëjmë me:	
Vargjet : ...Po, s'jemi turq, nuk jemi! Të dihet anë e mbanë: Shqiptarë dhe t'parët i kemi- Feja nga kombi s'na ndanë!	janë vargje:
Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë: Një ditë babai erdhi në shtëpi me një pako të madhe. Fëmijët e rrethuan të gëzuar dhe prisnin se çdo të nxirrte. - Është diçka që na duhet të gjithëve. Ai di pothuajse gjithçka. – tha babai. - Di t'i bëjë detyrat e matematikës? –pyeti Drita. - Di,- u përgjigj babai. - Di të shkruaj bukur? – pyeti Agroni. - Si të ta dojë e bardha zemër, - u përgjigj babai.	Ky tekst është:
Vargjet : Gjithë këta të mjerë Në të këqija rrojnë, Vin' e lipin në derë, Një kafshatë kërkojnë!	I përkasin poezisë:
Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë : Të të dridheshin gjunjë kur të niseshe për këtu. Së paku për hirin tim, të mua plakës së shushatur, të mua gjëmëzezës. Por ç'bëhet kështu? Ty po të ftoj në nëvalle? Dhe ti guxon të ngrihesh? Po vë buzën në gaz! Po ngrihesh! Daleni! Ç'bënikështu! Kjo është e tepërt! Gjynah nga zoti!	Ky tekst ku një personazh bisedon me veten paraqet:
Lexoni vargjet e mëposhtme dhe përgjigjuni pyetjes Në shkollën shqipe Unë po shkoj Shqip të mësoj- Popullin tonë Me anë të dijes Ta lartësoj...	Në këto vargje poeti i këndon:
Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë më poshtë - - Tani doreza ka edhe këmbë edhe sy, - qeshi Ana dhe e fshehu dorezën e saj pas shpine për të mos e parë i vëllai. Cilët fjalë nga teksti, nuk janë të autorit:	
Në vargjet e mëposhtme cakto cilat fjalë rimojnë O bilbil, e di se ç'dua, Andaj zëri i bukur i yt Ma dogji shpirtin mua	Edhe gjumë s'më hyn në syt!
Vargjet : Jam shqiptar e kosovar: Zot e krenar, -Zot e bujar- mbi këtë Dhe, që e kam fe	

e përmbi fe:
e kam Vatan!
E kam Atdhe! janë vargje:

Lexo vargjet dhe përgjigju pyetjes

Me të shtatë ngjyrat
Harkun tënd po thur.
O ndriçim i bukur,
Më dukesh si urë.
Lart të ngjitem, lart
Sipër teje dua.
Në ç'brigje mbështeten
Këmbëzat e tua?

Për kë flet poeti në poezinë e mësipërme:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

-Nëno!...
-Bir!
-Dua bukë!
Mëma hesht.
-Nëno!
-Bir!
-Ngriva!
Mëma psherëtin.
-Nëno!
-Bir!
-Më dhemb koka!
Mëma s'përgjigjet.
S'ka bukë, s'ka zjarr, s'ka të holla për doktor. Dhe djali psherëtin.

Sipas asaj që thuhet në dialogun e dhënë, kuptojmë se trajtohet tema e:

Lexo tekstin e dhënë dhe përgjigju pyetjes

Dita e bardhë, e tretur dikund lëshon shigjeta të flakta që t'i bie errësirës. Terri sundon botën, pastaj pushojnë edhe katundet rreth luginës, e nisin të ëndërrojnë në atë natë të gjatë.

Cili nga titujt e dhënë do t'i përshtatej tekstit:

Lexo vargjet e mëposhtme dhe përgjigju pyetjes

Gjithë njerëzit që janë
Vëllezër janë të tërë
Një mëm' e një atë kanë,
Nga një baltë janë bërë.

Pyetja : vargjet e mësipërme na mësojnë që të gjithë njerëzit:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Arbi është nxënës shumë i mirë. Ai mëson, është punëtor, i respekton më të mëdhenjtë, por ka vetëm një problem: ai nuk dëshiron të ketë asnjë shok, sepse mendon se ai është më i miri nga të gjithë dhe për këtë as shokët nuk e duan dhe nuk e marrin në asnjë lojë.

Njëra nga arsytet pse shokët nuk e duan Arbin është:

Lexo tekstin në vijim dhe përgjigju pyetjes

- Rrofsh e qofsh! – i thanë dhe e pyetën se ç'kërkonte për të mirën që u bëri.
- A e keni në dorë të më jepni force që t'i mund të gjithë ata që më bien më qafë? – u tha Muji zanave.
- Vetëm kaq do, Muj? – e pyetën ato.
- Kaq.

Teksti i dhënë është:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë

Korbi dhe mjellma

Kur korbi pa mjellmën, e pati lakmi për ngjyrën e pendëve. Duke menduar se ajo është e atillë sepse lahet, e la vatrën e vet ku ushqehet dhe filloi të jetojë buzë kënetave e lumejve. Megjithëse atje lahet gjithmonë, prapsepër nuk ndryshonte. Pasi i mungonte ushqimi, u shkatërrua fare.

Pyetja: Trego cilës formë letrare i takon teksti:

Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju pyetjes:

Atë ditë të gjithë ndjeheshin ndryshe.

Gratë qanin e burrat bërtisnin, ndërsa fëmijët qeshnin me të madhe. S'dinte njeriu se ç'të bënte!

Çka ndryshonte mes fëmijëve, burrave dhe grave?

Lexo tekstin dhe pastaj përcakto titullin që i përshtatet.

Ndryshe nga mëngjeset tjerë, ai mëngjes solli me vete edhe diçka tjetër. Përveç dritës së madhe që më sillte dita, ai mëngjes po sillte me vete një shportë të mbushur plot e përplot lule, zogj, gjelbërim, këngë, hare pune dhe shumë e shumë gjëra që mua më bënë të kujtojë një stinë, stinën për të cilën po ndjeja aq shumë mall. Ishte ajo stina e magjikshme që kishte trokitur në derën time.

Për cilën stinë bëhet fjalë në tekst:

Lexo tekstin e fabulës dhe përgjigju pyetjes së dhënë

Mizat

Mizat kur panë mjaltë në një enë, ranë aty dhe ia nisën të hanë me lezet, madje, për arsye të ëmbëlsisë ato nuk ndaheshin fare prej tij.

Meqënëse nuk mund të shkoqeshin prej mjaltit sepse u ishin ngjitur këmbët, duke u mbytur thanë:

-Sa fatzeza që jemi! Mbaruam për shkak të një kënaqësie të shkurtër.

Pyetja : Cila është porosia e fabulës:

Lexo tekstin në vazhdim dhe përcakto cila është porosia e tij:

Druvari dhe lisi

Druvarët çanin lisin me pykat (druntjë e mprehur) e bëra nga druri i tij.

Prandaj lisi tha:

-Nuk hidhërohem aq në sëpatën që më çan, se sa në pykat që janë bërë prej drurit tim.

Lexo tekstin në vazhdim dhe përcakto cila është porosia e autorit:

Dhelpra dhe lejleku

Një ditë dhelpra i tha lejlekut:

-Dëshiron të vish në shtëpinë time për darkë?

-Faleminderit, -ia ktheu lejleku- do të më bëhej qejfi shumë.

Por kur lejleku arriti në shtëpinë e dhelprës, pa se ajo e kishte hedhur ushqimin në dy pjata të cekëta.

Lejleku nuk mund të hante në to, për shkak të sqepit të tij të gjatë.

Si mbaroi darken e vet, dhelpra tha:

-Nuk të pëlqeu ushqimi? Në qoftë se nuk mund të hash gjë, atëherë po ha unë për ty.

Dhe dhelpra hëngri pjesën e saj dhe të misafirit.

S'kaloi shumë dhe lejleku i bëri dhelprës një ftesë për në shtëpinë e vet. Ai e hodhi ushqimin në dy qypa me grykë të gjatë.

Kësaj radhe ishte dhelpra që s'mund të arrinte ushqimin.

Asaj s'i mbeti tjetër, veç të lëpihej, ndërsa shikonte me zili se si lejleku hante të dy darkat.

Lexo tekstin dhe pastaj përcakto titullin që i përshtatet

Nxehtësi e ngrohtësi më fal ky diell, por më shumë më sjell gëzime që pjek jo vetëm frutat e kopshteve por edhe lëkurën time të bardhë. E pastaj deti, ai det i madh që më përplas nëpër dallgët e tij e më bën të ndjehem peshk, më mbush me jetë e më bënë që të dua shumë e më shumë këtë kohë e mos ndjej nxehtësitë e saj.

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Hana e vetmuar, fliste me diellin, natyrën, lulet sikur ata do ta dëgjonin dhe do t'i kthenin përgjigje:

-Lamtumirë, o diell i bukur! – tha ajo e pikëlluar duke ngritur duart në qiell.

-Lamtumirë pra, meqënëse tani e tutje jam dënuar të rroj në këto vende të mërziqshme, ku rrezet e tua nuk i gëzon njeri.

Pastaj bëri disa hapa jashtë shtëpisë, se grurin e kishin korrur dhe kishte mbetur vetëm kashta.

-Lamtumirë, lamtumirë! – tha ajo duke perqafuar një lule të vogël të kuqe. -Po e pe ndonjë herë dallëndyshen, përshendete nga ana ime.

Pyetja:Teksti është:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Një ditë një shkrimtar qëndronte i ulur pranë lumit. Rastësisht aty shikon se si dy fëmijë zihen. Shkrimtari pasi i ndan i pyet se cila ishte arsyeja që ata ziheshin. Njëri nga djemtë i tregoi të gjithë rrjedhën e ngjarjes, se si djali tjetër ia kishte vjedhur ngjyrat, e më pas i kishte rrahur të vëllanë. Shkrimtari pasi i dëgjoi fëmijët ndërhyri dhe me këshillat që ju dha i bindi ata, ju ndihmoi të bëhen shokë të mirë. Pastaj mendoi se këtë histori duhej ta shkruante e ta bënte tregim. Dhe kështu veproi.

Duke u bazuar në tekstin e dhënë, shkrimtari e shkroi tregimin sepse:

Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju pyetjes

Prindërit rrinë vetë si të shkretë. Edhe shtëpitë janë boshatisur. Fëmijët s'lozin më nëpër oborre edhe ato kanë mbetur të shprazët, prandaj edhe ato vuajnë njëlloj si prindërit dhe shtëpitë.

Çështë e përbashkët për prindërit, shtëpitë dhe oborret?

Lexo tekstin e dhënë dhe përgjigju pyetjes

Gjyshi i Erës po lexonte një libër me kopertinë të vjetër. Era iu afrua dhe i tha:

- Gjysh, librat e mi janë shumë të bukur, plot me ngjyra. Ky libër është i vjetër. Pse të pëlqen?
- Mojtë bijë, nuk ka rëndësi nëse libri është i ri apo i vjetër. Libri vlerën e ka brenda. Ja në këto faqet e shkruara.

Në tekstin e dhënë, fjalët e autorit janë:

Lexo vargjet e dhëna dhe përcakto titullin që iu përshtatet

Moti kanë heshtur zogjtë ndër drunjë.

Janë lodhur pulëbardhat në fluturim mbi ujë.

Edhe liqeni tani- hesht, hesht

Nën dritën e hënës që së larti sheh.

Në fjalinë: Lumi Drini i Zi, kalon nëpër qytetin e Strugës.

Fjala, Drini i Zi, është emër:

Në fjalinë: Genti mbante në dorë një çantë të kuqe.

Fjala, çantë, është emër:

Cila nga fjalët e mëposhtme është emër abstrakt:

Në fjalinë: Fshatarët punojnë gjatë gjithë verës.

Cila nga fjalët e fjalisë tregon veprim?

Lexo fjalinë dhe përgjigju pyetjes

Arta shkruan në ditarin e saj çdo ditë.

Në fjalinë e dhënë, folja shkruan është përdorur në kohën:

Në fjalinë: Gresa do të bëhet një mjekë e mirë. – folja do të bëhet është përdorur në kohën:

Në fjalinë: Ujku gojëmadh bridhte çdo ditë rrotull deleve.

Fjala, gojëmadh, është :

Teuta është një vajzë e sjellshme dhe e zgjuar.

Në fjalinë e dhënë fjalët : e sjellshme, e zgjuar janë:

Fjalët: Veturë dhe automobil kanë kuptim të njëjtë, por formë të ndryshme. Këto fjalë ndryshe quhen edhe:

Fjalët që shkruhen njëlloj dhe kanë tingëllim të ngjashëm, por ndryshojnë nga kuptimi i tyre, si p.sh.:

Bari (bimë që rritet në tokë) dhe

Barí (person që kullot kafshët), ndryshe quhen:

Cila nga fjalët : kush, por, edhe, sepse - mund të ndryshojë formën:

Emri, mbiemri, përemri, folja, si pjesë të ligjëratës janë:

Fjalët në vijim: ata, ne, kush, cili, cila, cilët janë:

Lexo fjalitë dhe përgjigju pyetjes

Jeta është vajzë e zgjuar. Ajo gjithmonë mban në duar një libër.

Cila nga fjalët e dhëna të përdorura në fjalitë e lartshënuara është përemër:

Cila nga fjalitë e dhëna është fjali dëftore:

Cili nga emrat e dhënë është shkruar saktë:

Lexo fjalitë dhe përgjigju pyetjes

-Ylli bleu një libër.

- Ai bleu një libër.

Emri, Ylli, në fjalinë e dytë është zëvendësuar me përemërin:

Në fjalinë : Kabinetet e shkollës sonë janë të pajisur me kompjuterë.

Emri , shkolla, ka marrë formën – e shkollës , në cilën rasën:

Fjalja: Flokët e kukullës sime janë të gjatë.

Emri *flokët*, është përdorur në rasën:

Në lakimin e dytë bëjnë pjesë emrat:

Fjalja: Fatjona stolisi bredhin me yje, llampiona dhe çokollata.

Fjalët: yje, llampiona, çokollata – janë:

Emri gjatë lakimit në rasi merr forma të ndryshme. Në cilën rasi është përdorur emri mësuesi në fjalinë e dhënë:

- Mësuesin gjithnjë duhet ta respektojmë.

Në cilin grup të emrave të dhënë kemi emra të përdorur vetëm në trajtën e shquar:

Në fjalinë: Artani është i punësuar dhe punon punë të ndryshme.

Fjala, *punë*, është përdorur në forma të ndryshme. Cila nga ato është emër:

Në fjalinë : Kreshniku besnik e realizoi detyrën në kohën e duhur.

Fjala, *besnik*, është:

Në fjalinë: Mali hijerëndë me lisat e tij të gjatë dukej që larg.

Dy mbiemrat e fjalisë janë:

Shkupi ka lagje të reja, parqe të lulëzuar dhe pallate të larta.

Sa mbiemra përmban kjo fjali:

Oborri i shtëpisë sonë është i mbushur plot me lule, të cilat na kënaqin me erën e tyre.

Fjalja e dhënë është fjali:

Cila nga fjalitë e dhëna është fjali e thjeshtë:

Sa kallëzues ka në fjalinë e dhënë:

- Babai i Lindës nuk punon askund, pasi fabrika falimentoi dhe tani është i papunë.

Në fjalitë:

- Liriu veshi rrobat e reja për festë.

- Artanit mbrëmë i dhimbte veshi.

Sipas kuptimit dhe formës që ka në fjalitë e mësipërme, fjala *veshi* është:

Në cilin çift fjalësh të dhëna të dyja fjalët kanë kuptim përkëdhelës:

Cila nga fjalitë e dhëna është shkruar sipas rregullave të drejtshkrimit:

Shenja e pikësimit është përdorur drejtë në fjalinë:

Çfarë funksioni kryen fjala, luan- Luan, në fjalitë e mëposhtme:

- Ti luan me topin si të jesh profesionist.

- Luan, a i bëre detyrat në matematikë?

Në cilën nga fjalitë e dhëna folja është përdorur në kohën e shkuar:			
Fjalja: - Babi a do të më qortosh për gabimin e bërë? – e pyeti Arta babain e saj. Në ligjeratën e zhdrejtë do të ishte:			
Fjalja: - Mamaja i thoshte Besës që të behej gati dhe të nisej për në shkollë. Në ligjeratën e drejtë do të ishte:			
Gjatë përdorimit në fjali ka fjalë që ndryshojnë formën dhe ka fjalë që nuk e ndryshojnë. Cili grup nga fjalët e dhëna janë të gjitha të pandryshueshme:			
Në cilën fjali folja është përdorur në kohën e ardhme?			
Fjalja:Genti e pyeti gjyshin se si përfundonte përralla. Në ligjeratën e drejtë do të ishte kështu:			
Njëri nga grupet e mëposhtme me nga tre fjalë, përbëhet nga të trija fjalët të cilat e ndryshojnë formën Cili është ai grup?			
Fjalja: - Era, a punojnë milingonat pa u ndalur?- pyeti Ana Në ligjeratën e zhdrejtë do të ishte:			
Në fjalitë: - Dje pata takim me kryetarin. - Sot pash disa pata në lumë. Fjala, pata, luan rolin si:			
Në fjalitë e mëposhme gjeni fjalinë ku folja është në kohën e kryer:			
Fjalisë: Zogjtë _____ fluturojnë lart në qiell. Cili nga mbiemrat e dhënë i përshtatet:			
Në fjalinë: Fëmijët e gëzuar, brohoritën kur panë se në lagje erdhi xhaxhi Gëzim. Fjala, gëzim, është përdorur në forma të ndryshme. Cilat janë ato:			
Në fjalitë: - Agimi është djalë i pashëm - Arta është vajzë e bukur. Fjalët: i pashëm - e bukur, janë:			
Kemi fjalë që shkruhen njësoj por ndryshojnë sipas kuptimit. Në fjalitë: - Gjuha është ajo që e bashkon një komb. - Gjuha është organ që ndodhet në gojë. Fjala gjuha është:			
Lexo fjalinë dhe përgjigju pyetjes - Teuta fliste ngadalë, bukur, me një zë të ëmbël dhe mahnitës. Fjalja e dhënë është fjali :			
Cila nga fjalitë e dhëna është fjali e përbërë:			

Vepra dramatike e cila përqesh veset e këqija të shoqërisë dhe e realizon këtë gjithmonë me anë të nuancave të qesharakes, quhet:		
Veprat në të cilat kafshët ose sendet alegorisht paraqesin tipa të veçantë të njerëzve, quhen:		
Ngjarjet e treguara në një vepër gjithmonë kanë një mendim kryesor, i cili ndryshe quhet:		
Vepra dramatike në të cilën personazhi lufton për idealet e veta, për qëllime të larta shoqërore dhe që ka një fund të hidhur quhet:		
Krijimet letrare që shkruhen në vargje, por që në vetvete përshkruajnë një ngjarje historike nga fillimi deri në fund, ndryshe quhen:		
Cilat nga vargjet e mëposhtme rimojnë: Ku kam fis e ku ka farë, Ku kam qeshur, ku kam qarë, Ku rroj me gaz e me shpresë, Ku kam dëshirë të vdesë.		
Vargjet e mëposhtme në të cilat poeti i këndon atdheut, i përkasin poezisë: Ty atdhe secili të do Si diellin, si ajrin Si ushqimin që ha Si nënën, si babanë.		
Bashkëbisedimi midis dy apo më shumë personave, në një vepër letrare quhet:		
Dukuritë, ngjarjet të cilat poeti i zgjedh nga realiteti dhe i përmbledh apo përgjithëson në veprën letrare, ndryshe quhen:		
Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë: Një ditë te mbreti erdhi një fshatar, i cili i tha: Fshatari: Madhëri, kthemi florinj të e mi! Mbreti: Florinj të? - u habit mbreti. Fshatari: Po, m'i more javën e kaluar. Mbreti: Gënjen, s'të kam marrë asgjë, - bërtiti mbreti. Ky tekst është:		
Vargjet : Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi, kafshatë që të mbetë në fyt edhe të zë trishtimi kur shef ftyra të zbeta edhe sy t'jeshilta që t'shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin të tan jetën e vet derisa të vdesin. I përkasin poezisë:		
Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë : ...Laura e shtrirë në shtrat vazhdonte të mendojë dhe të pyeste veten: cilin fustan do të vesh nesër? Cilën kordelë ta vë në kokë: të blertën, të kaltërtën apo të kuqen? Po mësuesi apo mësuesja ime, si do të jenë? Ky tekst ku një personazh bisedon me veten paraqet:		
Lexoni vargjet e mëposhtme dhe përgjigjuni pyetjes Burra nën hie, lozin, kuvendojnë, pika që s'u bie, se nga gratë rrojnë! Gratë venë nd'arë, dhe në vreshta gratë,		

<p>gruaja korr barë, punon dit' e natë Në këto vargje flitet për:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë</p> <p>Gjyshja e zverdhur doli në oborr dhe deshi ta qortojë Ritën, mirëpo Rita nuk i dha kohë, e përqafoi vullshëm dhe iu drejtua: -Gjyshëza ime, u merakose shumë nga vonesa ime?</p> <p>Cilët fjalë nga teksti, nuk janë të autorit:</p>	
<p>Vargjet : O ata t'lumtë, qi dhanë jetën, o ata t'lumtë, qi shkrinë vehten, qi për Mbret e vend të Parëve, qi për erz e nderë t'Shqiptarëve derdhën gjakun tue luftue, porsi t'Parët u pa'n punue! janë vargje:</p>	
<p>Lexo vargjet e mëposhtme dhe përgjigju pyetjes Nëpër fusha e nëpër male Fryn murlani me stuhi O murlan, njat frymën ndale Ndal ti, o akull, mos më ngri. Mos ma ngrini këtë pikë gjak! Struku, struku, i shkreti plak. Cili nga titujt e mëposhtëm do t'i përshtatej poezisë</p>	
<p>Lexo vargjet dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Shkon te vjollca e vetmuar, Rrugës ndalet dhe n'behar, S'mendon dot për të pushuar, Pos' kur ngopet me nektar.</p> <p>Thonë se krahët i ka t'artë, Thonë se fëmijët i do pa masë, Prandaj n'hoje kur bën mjaltë, Mund të ngihet krejt një klasë. Për kë flet poeti në poezinë e mësipërme:</p>	
<p>Në një vepër letrare flitet për: - <i>Mospërdorimin e drogës</i> - <i>Dhunën në familje</i> - <i>Përtacinë e tepruar</i> Këto janë probleme të cilat autori i ka marrë nga jeta reale dhe i ka futur në vepër. Të gjitha këto janë:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes "Gjithmonë do të kemi probleme me të cilat të rinjtë do të kacafyten. Do të duhet të krijojmë një njeri të ri, në çdo pikëpamje shumë më të mirë se sa është njeriu i sotëm. E ta ndërtojmë këtë njeri është shumë e mundimshme se sa të luftosh për lirinë e tij dhe mirëqenien e tij materiale. E kush do ta ndërtojë atë përveç se gjeneratat e reja që i zëvendësojnë të vjetrat!" Sipas asaj që thuhet në tekstin e dhënë, kuptojmë se kemi të bëjmë me motivin:</p>	
<p>Shpesh gjatë leximit të fabulave, shohim se në to personazhe kryesorë kemi kafshët apo shtazët. Këto personazhe gjithmonë kanë një qëllim të caktuar, që është:</p>	
<p>Vargjet: Skënderbeu, Trimi ynë Legjendar- Ësthë i njohur</p>	

<p>Për trimëri Në botën mbarë. - Janë vargje:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Drita ishte vajza më e vogël e lagjes dhe këtë gjë ajo e kishte problem. Kur donte të luaj me vajzat më të mëdha, ato nuk e përfillnin në lojë, sepse nuk iu përshtatej moshës dhe mënyra në të cilën dëshironte të luaj. Ajo ishte vetëm 5 vjeç dhe kënaqej me lojra të thjeshta.</p> <p>Njëra nga arsytet pse vajzat e mëdha të lagjes nuk e përfillnin Dritën është:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p><i>Agimi shkruante poezi. Ai një ditë u lexojë nxënësve në klasë një poezi ku përqeshte fëmijët përtaçë. Të gjithë nxënësit qeshën shumë, por edhe e kuptuan se sa keq dukej ai që është përtaç.</i></p> <p>Poezia që kishte shkruar Agimi ishte poezi:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë</p> <p><i>BUJKU DHE TË BIJTË</i> <i>Një bujk i kamur vdekjen kur ndjeu se e kishte pranë</i> <i>Thërret të bijtë e u flet pasi i merr mënjanë:</i> <i>“Shikoni mirë, u thotë, - mos shitni trashëgiminë</i> <i>Që na kanë lënë të parët tanë,</i> <i>Se brenda një thesar na lanë.</i> <i>Unë vendin nuk e di, por, me pak guxim,</i> <i>Për besë do ta gjeni, punoni pa përtim.</i> <i>Lëroni arën krejt, gërmoni, anembanë,</i> <i>Sa gushti të ketë kaluar;</i> <i>Mos lini një pëllëmbë tokë pa e punuar”</i> <i>Babai sa mbylli sytë, të bijt me t’iu përveshën</i> <i>Punës me hov të madh: gërmuan, deshën s’deshën</i> <i>Aty, këtu, aq shumë sa , kur u mbush një vit</i> <i>Një grurë i bukur aty u rrit</i> <i>Të holla as një dysh, por babai, nje ditë</i> <i>U kish treguar, plot urti</i> <i>Se puna është flori.</i></p> <p>Porosia e fabulës është:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe pastaj përcakto titullin që i përshtatet.</p> <p>Atë mëngjes një zog trokiti në dritaren e dhomës. Ishte zogu lajmëtar që bashkë me cicërimën e tij, futi në dhomë edhe rrezet e e arta të diellit. Një erë e këndëshme lulesh më dehën me atë aromë dhe unë hapa dritaren, për të parë gjelbërimin që kishte veshur natyrën, mozaikun shumëngjyrësh që krijonin lulet dhe për të dëgjuar meloditë e bukura të zogjve që sollën atë ditë.</p> <p>Për cilën stinë bëhet fjalë në tekst:</p>	
<p>Lexo tekstin e fabulës dhe përgjigju pyetjes së dhënë</p> <p>Dy bretkocat</p> <p>Kur shteroi pellgu, dy bretkosa u larguan prej andej, për të gjetur një vend tjetër me ujë. Sapo mbërritën në një pus, njëra prej tyre, pa u menduar, i tha tjetrës të zbrisnin atje. Por tjetra i tha:</p> <p>- Po nëse shteron uji që është aty posht, atëherë si do të të dalim jashtë?</p> <p>Fabula na meson:</p>	
<p>Lexo tekstin në vazhdim dhe përcakto cila është porosia e tij:</p> <p>Një grua e ve kishte një pulë, që i bënte nga një vezë çdo ditë. Mendoi se po t'i shtonte ushqimin, pula do t'i bënte nga dy vezë në ditë. Dhe kështu bëri. Por, pula u trash aq shumë, sa nuk mund të bënte as edhe një vezë të vetme.</p>	

<p>Lexo tekstin në vazhdim dhe përcakto cila është porosia e tij: Dreri dhe hija e tij Një dre i etur erdhi tek një burim. Ndërsa ishte duke pirë ujë, vuri re në ujë hijen e vet e filloi të mburret për brirët e vet, duke parë madhësinë e bukurinë e tyre, kurse për këmbët e veta u hidhërua që i kish aq të holla e të hajthme. Derisa ende ishte duke menduar për këtë gjë, ia behu luani e filloi ta ndjekë. Dreri ia dha këmbëve dhe u largua mjaft prej luanit. Për sa kohë vrapoi në fushë pa drurë, dreri vrapoi mirë e i shpëtoi rrezikut, por kur mbërriti në pyll, në një vend me drurë të dendur, brirët iu ngatërruan nëpër degët e drunjëve. Dhe pasi nuk mundi të vrapojë më, luani e kapi.</p> <p>Porosia e fabulës është:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe pastaj përcakto titullin që i përshtatet</p> <p>Nxehtësi e ngrohtësi më fal ky diell, por më shumë më sjell gëzime që pjek jo vetëm frutat e kopshteve por edhe lëkurën time të bardhë. E pastaj deti, ai det i madh që më përplas nëpër dallgët e tij e më bën të ndjem peshk, më mbush me jetë e më bën që të dua shumë e më shumë këtë kohë e mos ndjej nxehtësitë e saj.</p>	
<p>Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjes</p> <p>“Unë nuk e di i cilës ushtri je ti, sepse asnjëherë nuk i kam njohur rrobat e ushtrisë dhe tani jam shumë plakë për t’i mësuar, por ti je i huaj dhe je një prej atyre ushtrive që na kanë vrarë. Ti ke zanatin e mallkuar të luftës dhe je një prej atyre që më kanë bërë mua gjysmënjeriu, një copë plakë të shushatur, që vjen në këtë dasmë të huaj dhe rri në qoshe dhe lëviz buzët, duke biseduar me ty. Asnjë nuk e di ç’them unë, sepse të gjithë janë shumë të gëzuar dhe une nuk dua t’ua prish gëzimin. Ngaqë nuk dua të prish gëzimin, po rri këtu në qoshe dhe lëviz buzët, duke mallkuar ngadalë, që të mos dëgjojë njeri...”</p> <p>Fragmenti i dhënë është:</p>	
<p>Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjes</p> <ul style="list-style-type: none"> - Domethënë askush nuk di të lexojë në fshat?! – pyeste djaloshi, thuajse nuk i besonte. - Askush... - As kryeplaku? - As ai. - Përse nuk ka shkuar dikush nga fshati të shkollohet në qytet? – pyeste bariu si të ishte i xigëluar e i etshëm për dituri. - Në tërë qytetin është vetëm një shkollë. Aty nuk ka vend as për të gjithë fëmijët e pasanikëve, e jo më për ne fshatarët... <p>Teksti i mësipërm paraqet:</p>	
<p>Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjes</p> <p>Një ditë klasa e pestë e shkollës “Naim Frashëri” shkuan në ekskursion në qytetin e Strugës. Atje patën shumë momente të bukura të cilat Agroni nuk do t’i harrojë kurrë. Ai porsa erdhi në shtëpi menjëherë shkroi një tregim të titulluar “Shetitje pranë liqenit” dhe ua lexoi shokëve në shkollë, të cilët e pëlqyen shumë pasi edhe vetë ishin pjesë e tregimit.</p> <p>Duke u bazuar në tekstin e dhënë, shohim se për ta shkukur tregimin Agroni:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju pyetjes</p> <p>Atë ditë gjeli kishte lajmëruar më herët mëngjesin, pastaj fëmijët ia thoshin një kënge që kishin dëgjuar aty-këtu nëpër rrugë. Gratë e shtëpisë dëgjonin se si radioja nxirrte atë melodi interesante dhe e imitonin atë, e burrat në ara të gëzuar kujtonin këngët e dashurisë.</p> <p>Çështë e përbashkët për gjelin, fëmijët, gratë dhe burrat:</p>	
<p>Lexo tekstin e dhënë dhe përgjigju pyetjes</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nexhat-bej, sa shkollë ke bërë? - Nexhati përgjigje rëndë-rëndë: - Isha punëtor, s’kisha nge të mësoja, punoja për të nxjerrë bukën e gojës. - As filloren nuk munde ta mbaroje? - Nuk munda. - S’ke bërë as dy vjet shkollë? - Jo. - Atëherë çfarë kupton nga ky libër? 	

<p>Në tekstin e dhënë, fjalët e autorit janë:</p>	
<p>Lexo vargjet e dhëna dhe përcakto titullin që iu përshtatet</p> <p>Dhe vjeshta shkoi, fletët e saj I vërvit era, i përpjek. Ai si perandori kinez Ngjyrën e verdhë kudo e ndjek.</p> <p>Dhe këto re që tani vijnë Ndryshe nga retë e gjertanishme, Të shkreta janë, pa vetëtima, Porsi djerrina të mërzitshme.</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes Plaku dhe plaka</p> <p>Na rronin njëherë një plak e një plakë. Ata ishin shumë të varfër. Nuk kishin gjë tjetër, veç një gjel e një qen. Një ditë qeni i tha gjelit: Eja, gjel i dashur, të shkojmë në pyll, të gjejmë ndonjë gjë për të ngrënë. U nisën. Kur po errësohej, u futën në pyll dhe zgjodhën për të fjetur një pemë me zgavër. Gjeli hipi në pemë, qeni u fut në zgavër. Në mëngjes gjeli nisi të këndonte: ki!- kii! - kiii! Me ta dëgjuar dhelptra, iu afrua pemës dhe filloi të lavdëronte gjelin. - Sa i bukur qenke, o gjel! Sa zë të ëmbël që paske! Eja sot për drekë tek unë, se të dua shumë! - Mirë, - i tha gjeli, - por unë kam edhe një shok. - Ku është shoku yt? - pyeti dhelptra. - Ja, atje, në zgavër, iu përgjigj gjeli. Dhelptra iu afrua zgavrës dhe futi kokën. Qeni e kapi për fyti dhe e mbyti.</p> <p>Cili është mesazhi (porosia) i tregimit:</p>	
<p>Personi që shkruan të gjithë ngjarjen e një filmi, cakton personazhet, temat, motivet ejt., ndryshe quhet:</p>	
<p>Personi që kujdeset për zhvillimin e filmit, aktivitetet që kryhen në film, ambientet ku duhet zhvilluar etj., duke u bazuar në skenar, quhet:</p>	

<p>exo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Familja katër anëtarëshe e Agnesës shkuan në teatrin e qytetit për të parë një shfaqje kulturore. Shfaqja ishte e ndarë në akte dhe zgjati gjithsejt afër 90 minuta. Ata panë nga afër aktorët, përcollën mënyrën se si interpretonin rolet e tyre në skenë, veshjet etj. Pyetja: Çfarë kanë parë anëtarët e familjes në teatrin e qytetit?</p>	
<p>Personi i cili kujdeset për veshjen e aktorëve në një shfaqje teatrale, quhet:</p>	
<p>Teksti letrar që përmban përshkrimin e ngjarjeve e të veprimeve, dialogët e personazheve dhe që shërben si bazë për një film, quhet:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Nxënësit e shkollës “Naim Frashëri” shkuan në shtëpinë e kulturës së qytetit të tyre për të parë një shfaqje që zgjati 2 x 45 minuta. Ata panë nga afër aktorët, mënyrën se si i interpretonin rolet e tyre në skenë, veshjet etj. Pyetja: Çfarë kanë parë nxënësit në shtëpinë e kulturës?</p>	

<p>Nxënësve të klasës së pestë ju është dhënë për detyrë që të radhisin librat e bibliotekës së shkollës. Ata u ndanë në katër grupe dhe i radhitën librat në këtë mënyrë:</p> <p>GR.I – i radhiti ashtu si i mirrin në dorë dhe i vendosnin në rafte, GR.II – i radhiti sipas fushës, lëmisë kujt i takon libri, GR.III – i radhiti sipas mbiemrit të autorit duke pasur parasysh edhe alfabetin, Gr.IV – i radhiti sipas asaj se si u pëlqente ashtu i vendosnin në rafte.</p> <p>Pyetja: Cilët grupe i radhitën librat saktë:</p>	
<p>Lexoni tekstin dhe përgjiguni pyetjes</p> <p>Nxënësit e klasës së pestë një orë mësimi u futën në një klasë për të parë diçka. Në një moment u fikën dritat dhe në një ekran u shfaqën disa figura, aktorë të cilët luanin role të ndryshme dhe që ishin pjesëtarë të një ngjarjeje. Aty nxënësit qëndruan rreth 1 orë e 40 minuta.</p> <p>Në rastin e dhënë, nxënësit panë (shikuan):</p>	
<p>Nëse kemi lexuar një vepër dhe pastaj për personazhin kryesor i themi një shoku se si dukej ai nga pamja e jashtme, çfarë pëlqente për të veshur, si fliste, dhe si hante themi se bëjmë:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë</p> <p>Bisedonin dy shoqe për atë se sa rendësi kanë pemët për njeriun. Arta i tha shoqes së saj Arjetës se babi i ka treguar se druri më i gjatë është një pemë e drurit të kuq që quhet Druri më i Lartë dhe është 121 metër i lartë.</p> <p>Në tekstin e dhënë duket se Arta:</p>	
<p>Nëse gjatë hartimit me shkrim shkruajmë për mesazhin që duam të përcjellim, rendësinë që ka tema për të cilën shkruajmë, ky tekst do të ishte:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p><i>Revista për fëmijë "Fatosi" është një revistë me 30 faqe. Ajo përmban shumë tregime, poezi dhe lojëra për t'u zbavitur. Ka edhe ilustrime të nxënësve.</i></p> <p>Teksti i dhënë është:</p>	
<p>Kur i drejtohem me shkrim një organi zyrtar , për të na u përgjigjur për diçka për të cilën kemi nevojë, themi se bëjmë:</p>	
<p>Kur duam të shprehim me shkrim a me gojë për pamjen e jashtme të një njeriu, të një sendi apo të një vendi, themi se bëjmë :</p>	
<p>Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju në pyetjen e dhënë</p> <p>Nata po afrohet. Drita e ditës tretet dalëngadalë; e, mbi tjegullat e shtëpive, mbi dërrasat e rrugëve, mbi fletët e pemëve, mbi trupet e epta të çupave që shkojnë, një ngjyrë manushaqeje – një ngjyrë gushë pëllumbi, si thonë në ca male t'ona, - shtrihet, e i mpështjell. Mbasandaj, pak nga pak manushaqet çfletohen. Hijet bëhen më të dendura, më të zeza. Njëri mbas tjetrit, yjtë çpojnë qiellin, e pikëlojnë dritë. Nata u afrua. Nata erdhi.</p> <p>Ky tekst është:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju në pyetjen e dhënë</p> <p>Ana e errët e Hënës</p> <p>Ne asnjëherë nuk e shohim njëri-njëri anë të Hënës, sepse po e njëjta faqe është gjithmonë nga ana e Tokës. Ana e prapme e Hënës ka qenë një gjë e fshehtë derisa u fotografua nga një anije kozmike në vitin 1959.</p> <p>Ky tekst është:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Në klasën e pestë bibliotekisti i shkollës lexon një letër, në të cilën shkruan se: Të gjithë nxënësit që kanë marrë libra nga biblioteka e shkollës dhe nuk i kanë kthyer përsëri, janë të obliguar që t'i kthejnë brenda dy ditësh. Në rast se ata nuk e bëjnë këtë, do të dënohen që të paguajnë një shumë të hollash.</p> <p>Në këtë rast, letra që lexoi bibliotekisti ishte:</p>	



<p>Lexo tekstin e mëposhtëm dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Blerta është nxënëse e klasës së tetë. Ajo është pesëmbëdhjetë vjeçe. Është e gjatë rreth 175 cm dhe është elegante. Ka flokë të zinj dhe të gjatë. Sytë e saj janë ngjyrë gështenje, hunda e saj është e vogël, ndërsa buzët e mëdhaja dhe të trasha. Ajo mban syze dhe një kordelë në kokë. Gjithmonë është e qeshur dhe shumë simpatike, me një fjalë është një shoqe shumë mirë.</p> <p>Teksti është:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p><i>Sara po fliste me Jehonën për një film vizatimor që e kishte parë një ditë më parë, duke i thënë: Sara a e di sa interesant ishte! Tomi dhe Xheri duhet të shkojnë në vendin e quajtur Oz që ta shpëtojnë princeshën apo vashën e tyre të bukur. Tomi dhe Xheri bien dakord që të jenë miq të ngushtë deri në shpëtimin e saj. Është shumë argëtuese t'i shohësh si luftojnë bashkë dhe ia arrijnë qëllimit.</i></p> <p>Sipas asaj që thotë Sara, teksti i dhënë është:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Ana dhe Teuta po bisedonin për ndonjë gjë që iu kishte ndodhur në jetë. Ana tha: - E di Teutë? Njëherë kur isha me pushime në det, rrija gjithë ditën duke bërë një kala me rërë. Mamaja më thoshte eja në hije se do të digjesh nga dielli, unë nuk e dëgjoja. Pastaj kur ikëm nga plazhi unë fillova të ndjej dhimbje në kurriz, isha djegur shumë dhe s'pushoja së qari. Më kujtohet si sot! Por, tani e kam kuptuar gabimin tim dhe sa herë që shkojmë në pushime unë i ruhem diellit, qëndrojë më shumë nën hije.</p> <p>Në tekstin e dhënë Ana:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Nxënësit e klasës së 5A bënë një vizitë në muzeun e qytetit. Pas kësaj vizite arsimtari kërkoi nga nxënësit që për detyrë shtëpie të shkruajnë për këtë vizitë, që nga momenti i nisjes e deri në fund.</p> <p>Në këtë rast arsimtari nga nxënësit kërkoi të:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Shkolla "Naim Frashëri"</p> <p>Me rastin e kremtimit të Festës së Flamurit, më datë 28 Nëntor nuk do të mbahet mësim. Një grup i nxënësve të shkollës "Naim Frashëri" kanë përgatitur aktivitete të ndryshme për nder të kësaj dite. Aktivitetet do të zhvillohen në sallën sportive të shkollës në ora 12:30. Të gjithë arsimtarët, nxënësit dhe punonjësit tjerë të shkollës janë të mirëpritur për t'iu bashkangjitur kësaj feste.</p> <p>Teksti i dhënë është:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Hëna është sateliti i vetëm natyror i tokës. Është i vetmi trup qiellor astronomik, që deri tani është shkelur nga këmba e njeriut, dhe kështu edhe më i studiuar. Megjithatë ajo mban në vetvete ende shumë të fshehta, si krijimi dhe format e truallit të saj. Zhvillimi i saj i mëvonshëm dhe ndërtimi i saj i brendshëm janë sqaruar viteve të fundit. Shenja e zakonshme për hënë është mpakja, që shikohet nga gjysma e lëmshit tokësor (hemisfera) të veriut në trajtën e një drapëri hënor . Hëna është rreth 384.000 km larg Tokës.</p> <p>Teksti i dhënë është:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju se çfarë teksti është:</p> <p>Kur vetë njeriu, i lirë e i vetëm, larg atdheut - viset e reja, ndryshimi i zakoneve, ëmbëlsia e udhëtimit e një mijë gjëra që vihen re ndër popuj të huaj, të gjitha këto ta përgëzojnë zemrën e të bëjnë jo të harrosh atdheun, po të mos të vejë tek ajo aq dendur mendja. Më tutje, si ngopen sytë së pari ndryshime, gazi shuhet pak nga pak. S`di ç`të mungon, s`di se ç`të duhet. Një hije trishtimi ta mbulon fityren; e, pikë së pari herë-herë, pastaj më dendur e më në fund shpesh e pothuaj kurdo e kudo, kujtimi i prindërve, i miqve e shokëve, kujtimi i dheut ku u lindëm e u rritëm.</p> <p>Teksti i dhënë është tekst:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju se çfarë teksti është:</p> <p>Kur vetë njeriu, i lirë e i vetëm, larg atdheut - viset e reja, ndryshimi i zakoneve, ëmbëlsia e udhëtimit e një mijë gjëra që vihen re ndër popuj të huaj, të gjitha këto ta përgëzojnë zemrën e të bëjnë jo të harrosh atdheun, po të mos të vejë tek ajo aq dendur mendja. Më tutje, si ngopen sytë së pari ndryshime, gazi shuhet pak nga pak. S`di ç`të mungon, s`di se ç`të duhet. Një hije trishtimi ta mbulon fityren; e, pikë së</p>	

<p>pari herë-herë, pastaj më dendur e më në fund shpesh e pothuaj kurdo e kudo, kujtimi i prindërve, i miqve e shokëve, kujtimi i dheut ku u lindëm e u rritëm.</p> <p>Teskti i dhënë është tekst:</p>			
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë <i>Drita, mamaja ime më tha se në trupin e njeriut ka afër 206 kocka. Të gjitha këto janë të lidhura me nyjet për të formuar skeletin. Pa këtë ne do të ishim një shuk mishi.- thoshte Hana.</i></p> <p>Në tekstin e dhënë duket se Hana:</p>			
<p>Nëse shkruajmë me qëllim për të treguar një histori, një ngjarje a një përvojë të vërtetë ose të përfytyruar, atëherë ne kemi bërë një lloj shkrimi si:</p>			
<p>Kur rrëfejme për një ngjarje apo ndodhi të cilën e kemi dëgjuar më parë nga dikush, themi se është:</p>			
<p>Për formën e të shkruarit që shërben për të ndërtuar dhe ruajtur një raport të caktuar me një person tjetër, themi se është:</p>			
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Libri “Gjuha shqipe dhe Leximi” për klasën e pestë përveç se është një libër shumë i mirë, është edhe shumë tërheqës. Që nga kopertina e tij vërehen ilustrimet e bukura edhe në brendi të tij ka shumë figura e vizatime, vjersha dhe tregime interesante që ngjallin kërshtëri te nxënësit</p> <p>Teksti i dhënë është:</p>			
<p>Nëse një organi zyrtar i dërgojmë një shkresë, për të na plotësuar diçka për të cilën kemi nevojë, themi se bëjmë:</p>			
<p>Nëse na jepen të dhëna për një ndodhi apo ngjarje që do të ndodhë, themi se kemi të bëjmë me:</p>			
<p>Ato që shprehim me shkrim a me gojë kur duam të japim pamjen e jashtme të një njeriu, të një sendi apo të një vendi, themi se kemi të bëjmë me:</p>			
<p>Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju në pyetjen e dhënë</p> <p>Qielli po zbardhohet. Drita e ditës afrohet dalëngadalë; e, mbi pemët fillojnë të cicërojnë zogjtë, që me melodinë e tyre dëshirojnë t’i zgjojnë dhe kënaqin ato që çohen për të shkuar në punë. Pastaj, pak nga pak lulet hapin petalet e tyre dhe ne ndjejmë aromën e tyre. Dita u afrua. Dita erdhi.</p> <p>Ky tekst është:</p>			
<p>Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju në pyetjen e dhënë</p> <p>Rreth një e pesta e sipërfaqes së Tokës është shkretëtirë. Shkretëtirat janë vendet më të thata e më të nxehta mbi Tokë. Atje bie më pak se 250 mm shi në vit.</p> <p>Ky tekst është i llojit :</p>			
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Në klasën e pestë përgjegjësi i shkollës lexon një letër, në të cilën shkruan se: Më datë 21 Mars (Dita e ekologjisë), organizohen aktivitete për pastrimin e ambienteve shkollore, mbjelljen e pemëve dhe aktivitete të lira nga vetë nxënësit. Të gjithë nxënësit janë të obliguar që të bashkohen në këtë aksion.</p> <p>Në këtë rast, letra që lexoi përgjegjësi ishte:</p>			
<p>Lexo tekstin e mëposhtëm dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Shpendi është nxënës i klasës së gjashtë. Ai është shumë i pashëm. Ka flokë të kafta dhe sy gështenje. Hundën e ka pak të gjërë dhe buzët e fryra. Ai është shumë i sjellshëm dhe punëtor. Në shkollë është zgjedhur nxënësi më i mirë dhe shokët e duan shumë.</p> <p>Teksi paraqet:</p>			
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p>			

<p>Drini dhe Trimi flisin për filmat e tyre të preferuar. Drini filloi t'i tregojë Trimit për një film që kishte parë. Unë pash një film që u mahnita, Trimi! Bëhej fjalë për një djalë të ri i cili i mbijeton një fatkeqësie në det dhe përfundon në një udhëtim epik, me aventura dhe zbulime. Gjatë udhëtimit, ai formon një lidhje të papritur me një tjetër të mbijetuar ... një tigër të frikshëm. Ai qëndron bashkë me tigrin në varkë me ditë të tëra. Është interesante mënyra se si ai mbrohet prej tij dhe në fund miqësohet me të.</p> <p>Sipas asaj që thotë Drini, teksti i dhënë është:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Andi dhe Dea bisedonin mes veti dhe tregonin ndonjë kujtim nga jeta. Dea tha: - Nuk mund ta harroj asnjëherë, ditën kur isha në pushime me familjen time në Turqi. Një ditë vendosëm të shetisim në det të hapur me anije. Për fatin tonë të mirë dhe udhëtarëve të tjerë, u afruan pranë anijes dy delfinë. Nuk e ke idenë se sa shumë u gëzuam të gjithë dhe çfarë ndjesie e bukur ishte t'i shikoje ata aq afër.</p> <p>Në tekstin e dhënë Dea:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Artani dhe Gazmendi kishin shkuar në qytetin e bukur të Krujës. Atje kishin vizituar një sërë monumentesh, ndër të tjerat edhe kalanë e qytetit ku kishte luftuar heroi ynë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu. Pasi ata shkuan në shtëpi menjëherë filluan të shënojnë se si kishin kaluar dhe ç'kishin bërë atje.</p> <p>Në këtë rast Artani dhe Gazmendi bënë:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Shkolla "Sami Frashëri"</p> <p>Me rastin e 1 Qershorit, ditës së fëmijëve, shkolla jonë organizonë "Ditën gazmore" si vitet e tjera. Të gjithë nxënësit, arsimtarët, punonjësit dhe prindërit janë të mirëpritur për ta festuar këtë ditë.</p> <p>Teksti i dhënë është:</p>	
<p>Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes</p> <p>Në botë ka mbi 350.000 tipa të ndryshëm bimësh. Të gjitha qeniet e gjalla varen prej bimëve për të mbijetuar. Njerëzit dhe kafshët kanë nevojë për oksigjenin që e nxjerrin bimët që të marrin frymë. Bimët përdorin dioksidin e karbonit, të cilin njerëzit dhe kafshët e nxjerrin me frymë.</p> <p>Teksti i dhënë është:</p>	
<p>Lexo tekstin e fabulës dhe përgjigju pyetjes së dhënë</p> <p>Luanesha dhe dhelpira Kur dhelpira e qortoi një herë luaneshën, që gjithmonë pjell vetëm një këlysh, ajo u përgjigj: Një por luan.</p> <p>Fjala popullore që i përgjigjet porosisë së fabulës është:</p>	
<p>Lexo tekstin e fabulës dhe përgjigju pyetjes së dhënë :</p> <p>Bretkosat</p> <p><i>Kur shterroi pellgu, dy bretkosa u larguan prej andej, për të gjetur një vend tjetër me ujë. Sapo mbërritën në një pus, njëra prej tyre, pa u menduar, i tha tjetrës të zbrisnin atje. Por tjetra i tha:</i></p> <p><i>- Po nëse shterren uji që është aty poshtë, atëherë si do të mundim të dalim jashtë?</i></p> <p>Pyetja: Cila është porosia e fabulës</p>	
<p>Në krijimtarinë letrare poeti shpesh inicohet për të shkruar nga ndonjë shkak, ngacmim, arsye apo diçka tjetër.</p> <p>Në krijimet letrare këtë shkak, ngacmim apo arsye të poetit për të shkruar e quajmë:</p>	
<p>Vargjet :</p> <p><i>O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka.</i> <i>Më je nënë, më je motër, më je vlla.</i> <i>Nga ç'ka rrotull më i shtenjtë ti më je,</i> <i>Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhe</i></p>	

i përkasin poezisë:			
Fjala në të cilën është përdorur drejt shenja e pikësimit është :			
Fjalisë: <i>Po shkoj te im gjyshe? I tha Kësulkuaja</i>			
Është dhënë në ligjeratën e drejtë, cila nga fjalitë e poshtëshënuara në ligjeratën e zhdrejtë do t'i përgjigjeshte:			
Në fjalinë: <i>Nxënësit shkruajnë detyra në fletore.</i> Cila nga fjalët tregon veprim:			
Rretho shkronjën para përemrit që tregon frymorin a sendin që ndodhet afër folësit.			
Në fjalinë: Mësues Agimi, i mençur dhe punëtor çdoherë na jepte këshilla. Fjalët : i mençur dhe punëtor tregojnë:			
Biseda që e zhvillon një personazh duke folur me vetveten ose që u drejtohet lexuesve, dëgjuesve a shikuesve në një shfaqje teatrale, është:			
Fabulat janë:			
Në shumë vargje të poezive kemi përputhje të tingujve me zanore të theksuara. Lexo vargjet dhe shëno cilët fjalë në vargje rimojnë : <i>“Kroi i fshatit tonë ujë i kulluar, Çna buron nga mali duke mërmëruar Venë mbushin ujë vashat anembanë Cipëzën me hoja lidhur menjanë”</i>			
Shumë fjalë gjatë përdorimit në fjali e ndryshojnë formën. Cilat nga grupi i fjalëve të dhëna janë të gjitha të pandryshueshme.			
Foljet në fjali përdoren në kohë të ndryshme. Në cilët nga fjalitë e dhëna folja është përdorur në kohën e tashme.			
Në fjalinë: Prej librit gjithnjë mësojmë. Formën që ka emri libri në fjali është përdorur në rasën:			
Katër nxënës të ShF “Pranvera” nga Shkupi duhej të përcillnin disa informacione që fituan gjatë një hulumtimi deri te nxënësit e ShF “Drita” nga Tetova që kishin punuar në hulumtimin e njëjtë në vendin e tyre. Agimi tha që t’jua lëshojnë me postë, Drini tha të paraqiten në Radio dhe të transmetohen në një orë të caktuar, Teuta propozoj të përcillen nëpërmjet TV, kurse Besa dha mendim që t’i përcjellin nëpërmjet rrjetit të Internetit pasi që kishin e-mail adresën e tyre. Pyetja: Sipas cilit nxënës informacionet do të arrinë më shpejt te nxënësit e ShF “Drita” nga Tetova?			
Dekorimi i skenës bëhet që t'i përshtatet:			
Një autori i është dhënë të mendojë dhe të shkruajë një tekst që më pas do të xhirohet si një film. Me këtë rast autori ka bërë:			
Nxënës të një shkolle shkuan në Shtëpinë e kulturës së qytetit për të parë një shfaqje që zgjati 2 herë nga 45 minuta. Me këtë rast ato panë nga afër aktorët se si interpretonin rolet e tyre në skenë. Pyetja: Ç’farë kanë parë nxënësit në Shtëpinë e kulturës?			
Vargjet: Ku kam fis e ku kam farë, Ku kam qeshur, ku kam qarë, Ku rroj me gaz dhe me shpresë, Ku kam dëshirë të vdesë. i përkasin poezisë:			

Cili nga këto emra është abstrakt?			
Emri i cilës shkolle është shkruar pa gabime drejtshkrimore:			
Në çfarë marrëdhënie të ndërsjellë janë fjalët: gëzim-hidhërim, ditë-natë, dritë-errësirë, verë-dimër:			
Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë: Agimi: Më thanë se kanë ardhur të gjithë kurbetçinjtë, por dajën nuk e pash, Teuta: Ja ku e ke ulur tek stoli i fundit! Agimi: Mirë se erdhe dajë! Ky tekst është:			
Disa fjalë edhe pse ndryshojnë nga forma kanë kuptim të njëjtë ose të përafërt. Fjalëve të tilla ju themi:			
Në fjalinë: Një plak i ndershëm dhe bujar. Fjalët (mbiemrat): i ndershëm dhe bujar tregojnë:			
Fjalët që marrin forma të ndryshme gjatë përdorimit në fjali quhen:			
Kur një tekst lexohet rrjedhshëm, sipas intonacionit, ritmit dhe shenjave të pikësimit për atë lexim themi se është:			
Përemrat: kush, cili, cila, cilët, cilat janë:			
Foljet në fjali përdoren në kohë të ndryshme. Në cilët nga fjalitë e dhëna folja është përdorur në kohën e shkuar.			
Lexo fjalitë e poshtëshënuara dhe shëno çfarë funksioni kryen fjala <u>luan</u>? 1. <u>Luan</u> është prijësi i kafshëve të egra. 2. Artani <u>luan</u> me kafshët shtëpiake.			
Lexo tekstin e fabulës dhe përgjigju pyetjes së dhënë: Dallëndyshja dhe sorra Dallëndyshja dhe sorra u zunë (grindën) njëherë me fjalë se kush është më e bukur. Mirëpo sorra ia preu fjalën dhe ia ktheu: - Bukuria jote është në lulëzim të plotë në stinën e pranverës, kurse bukuria e trupit tim qëndron edhe gjatë dimrit. <u>Pyetja:</u> Cila është porosia e fabulës:			
Vargjet: Porsi vala e bregut të detit, Porsi gjama e rrëfësë zgetare Porsi ushtrimi e një tërmeti Njashtu është gjuha jonë shqiptare... I përkasin poezisë lirike:			
Foljet në fjali përdoren në kohë të ndryshme. Në cilët nga fjalitë e dhëna folja është përdorur në kohën e ardhme?			
Nëse autori përmes vargjeve përqesh dobësitë e një njeriu ose të mbarë shoqërisë për atë poezi themi se është:			
Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju pyetjes: Telat e rrymës janë të shkretë tha një fëmijë. Edhe çerdhet janë të shkreta shtoi një fëmijë tjetër. Drunjtë janë të vetmuar. Ndërsa foletë vuajnë.			

Ç'është e përbashkët për telat e rrymës, drunjtë dhe foletë?			
Anika gjatë të lexuarit të një teksti ka respektuar shenjat e pikësimit, intonacionin dhe ritmin e duhur. Për leximin e Anikës themi se është:			
Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë : ...Përse o bir, me gjithë mirësinë time, ti mua më le kështu? Më mirë do të ishte të më merrje me vete dhe të vdisja në duart e tua. Kështu jam e vetme si qyqane... Ky tekst ku një nënë shpreh ndjenjat për fatin e saj në vetvete paraqet:			
Shumë fjalë gjatë përdorimit në fjali e ndryshojnë formën. Cilat nga grupi i fjalëve të dhëna janë të gjitha të ndryshueshme?			
Mendimin kryesor që buron (del) prej ngjarjeve të cilat shkrimtari i shkruan në vepër na tregon:			
Sipas mbaresave që marrin në rasë, numër dhe trajtë emrat : bujku, zogu dhe tregu bëjnë pjesë në:			
Veptra që është e shkruar në prozë dhe përmbajtjen e së cilës e nënkuptojmë vetëm nëse e lexojmë gjithë librin quhet:			
Shpesh në vargje të poezive kemi përputhje të tingujve me zanore të theksuar. Lexo vargjet dhe shëno cilët vargje rimojnë. „Përmbi za që lëshon bilbili gjuha shqipe mshungullon; Përmbi erë qi nep zimbili po do zemrën ma ngushllon “			
Nëse në rrugë sheh shenjën me shkrim si më poshtë do të thotë se:			
			
Në hyrje të kinemasë së qytetit është varur një tabelë ku është shkruar një tekst si mëposht:			
			
Pyetja : A punon ditën e premte pasdite kinemaja:			
Nëse në rrugë sheh shenjën me shkrim si më poshtë do të thotë se:			

Teatër 20 m

Në hyrje të bibliotekës së qytetit është varur një tabelë ku është shkruar një tekst si më poshtë:

Orari i punës :

E hënë – e premte, 9.00 – 18.00

E shtunë , 9.00 – 13.00

Pyetja : A punon ditën e mërkurë pasdite biblioteka:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Mesuesja e gjuhës shqipe, një ditë i mori nxënësit e klasës së pestë për t'i çuar në një vend të veçantë. Kur hynë aty, nxënësit panë një skenë të madhe, aktorë të cilët flisnin drejtpërdrejt, e ishin të veshur me veshje të ndryshme. Ata të gjitha këto i panë dhe i dëgjuan nga afër, duke qëndruar aty rreth 2 orë e 30 minuta.

Në këtë rast, nxënësit kanë parë:

Në fjalinë: **Fatjona dhe Driloni janë nxënësit më të mirë të shkollës.**

Fjalët, Fatjona dhe Driloni janë:

Emër i përgjithshëm në fjalinë:

Arianiti shpesh e viziton librarinë.

është:

Në fjalinë: **Bleta mbledh nektar lule më lule.**

Cila nga fjalët tregon veprim?

Në fjalinë: Artani trazovaç ngacmonte shokët e tij.

Fjala, trazovaç, është:

Fjalët: gëzim, durim, hidhërim dhe ajër janë emra:

Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju në pyetjen e dhënë.

Arlindit gjyshi i kishte treguar një përrallëz dhe prej tij kishte kërkuar ta gjej porosinë e saj. Arlindi porosinë nuk e kishte qëlluar dhe pastaj gjyshi ia kishte treguar. Të nesërmen në shkollë Arlindi këtë j'ua tregoj shokëve ashtu si e kishte dëgjuar nga gjyshi.

Me këtë rast Arlindi ka bërë:

Nëse të janë dhënë fjalët si: *i kaltër, i pafund, hapësirë, i pastër, rreze dielli, retë si pluhur mielli*, etj. Po të kërkohej nga ty të flasësh ose shkruash një shkrim, ti do të kuptoje se bëhet fjalë për:

Lexo tekstin e dhënë dhe gjeje se çfarë lloj shkrimi është:

Sot para se të nisem për në shkollë në lajmet e orës 12.00, dëgjova se prej nesër moti do të ndryshojë dukshëm. Sipas parashikimeve të metereologëve javën që vjen do të kemi temperatura nën zero gradë celsius. Ky ndryshim i menjëhershëm për afër 12 gradë celsius, do të sjell edhe sëmundje të ndryshme. Prandaj, paralajmëruan dhe dhanë këshilla si të mbrohemi.

Lexo tekstin e dhënë dhe gjeje çfarë shkrimi paraqet ai:

Agjencia turistike "Qefaja", me një shkrim të saj në tabelën para hyrjes, tërheq qytetarët se ka bërë lirim të rezervimeve dhjetëditëshe për në liqenin e Ohrit, deri në 50 përqind. Aty ka shënuar edhe të dhëna të tjera që i përmban paketa e theksuar dhjetëditore, si dhe deri kur zgjat kjo ofertë.

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Bisedonin Premta dhe Agnesa. Në një moment Premta i thotë Agnesës: Agnesa mbrëmë e kam parë filmin vizatimor *Kung fu Panda*. Ishte shumë interesant. Grupi i ri i Kung Fusë dhe legjendat e vjetra bashkohen sëbashku që ta mundin një armik të vjetër që ishte Zoti Shen, i cili krijoi një armë dhe donte ta shtiente në dorë gjithë Kinën dhe botën. Pasi që ai i kishte vrarë prindërit Po-së, Po-ja i hakmirret, e mund armikun dhe pastaj këthehet në shtëpinë e prindërve të tij. Duhet ta shohësh edhe ti këtë film se është shumë interesant.

Në këtë rast Premta, Agnesës i ka:

Lexo tekstin dhe gjeje çfarë teksti është:

Kudo është bukuria,
Në qiej, në dhe, në hënë,
Në diell, në shenjë, në yj,
Ndër lule, ndër drurë, ndër pyj.

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

*E dashur Vjollca,
Ka shumë kohë që ne të dyja i kemi humbur kontaktet, unë nuk e kam as numrin tënd të telefonit që të të lajmëroj. Të lutem kur të ma këthesh përgjigjen shkruaje edhe atë. Si kalon me studimet? Ç'u bë me punën që doje të hyje? Ç'kemi të reja nga shtëpia?
Të përqafon Era,*

Teksti i dhënë është:

Lexo tekstin e dhënë dhe gjeje çfarë lloji teksti është:

**Kur më shikon të lumtur, më bën mbi dhe,
Të lumtur si nuk ka qenë njeri.
Dëftomu, e bukur, si një hënë e re,
Se jam këtu e pres me dashuri.**

Lexo tekstin dhe gjeje për çfarë teksti bëhet fjalë:

Uji i çmuar

Pa praninë e ujit, jeta në Tokë do të ishte e pamundur. Ky burim jetësor mbush oqeanet, liqenet, lumenjtë ose humbet në tokë, për të formuar pellgje uji nëntokësorë. Një pjesë gjendet në formë të akullit, në formë të avullit në ajër ose në trupin e kafshëve e të bimëve. Vetëm 3 përqind e ujit të Tokës është ujë i ëmbël. Uji që pimë nuk zë më shumë se 0,6 përqind të sasisë së ujit në botë.

Lexo tekstin dhe gjeje për çfarë shkrimi bëhet fjalë:

Muskujt

Muskujt vënë në lëvizje trupin e njeriut, duke u zgjatur ose duke u mbledhur e shkurtuar. Trupi i njeriut ka tre lloj muskujsh: skeletorë, kardiakë dhe muskujt e lëmuar. Njeriu ka rreth 650 muskuj skeletorë të shtruar përmbi skelet dhe e gjithë kjo masë përbën afro gjysmën e peshës së trupit tonë.

Lexo tekstin e dhënë dhe gjeje se për çfarë lloji të shkrimit bëhet fjalë:

Ishte një vend i mrekullueshëm. Aty të gjithë ishin të gëzuar. Burrat ishin shtatlartë, vajzat njëjtë si djemtë dhe belholla. Kudo ndjehej gëzimi, kudo ndjehej aroma e luleve, filladi që sillte uji i kulluar i liqenit dhe filladi i malit pranë. Atyre zoti u kishte falur të gjitha të mirat.

Nëse kemi shkuar në teatër dhe aty në skenë kemi parë veprime dhe sjellje të personazheve përmes monologjeve dhe dialogjeve të tyre, themi se kemi parë një:

Nëse bashkërisht angazhohen në një punë, skenaristi, regjisori dhe një numër i caktuar aktorësh dhe teknikësh, rezultati i asaj pune do të ishte:

Nëse një person udhëheq me të gjitha punët që kanë të bëjnë me xhirimin e një filmi atij i themi:

Gjatë xhirimit të një filmi angazhohen persona të ndryshëm. Mirëpo udhëheqja, kontrolli gjatë xhirimit dhe punët e tjera që lidhen me xhirimin i dirigjon personi që quhet:

Nxënësit e klasës së pestë të shkollës "Liria", ishin në shëtitje njëditore në Strugë. Atje ato vizituan bibliotekën e qytetit dhe mësuan për radhitjen e librave nëpër raftet. Aty mësuan edhe për botimin e disa gazetave. Pas vizitës mësuesja kërkoi nga nxënësit që në bibliotekën e shkollës së tyre të ndihmojnë në radhitjen e librave.

Këtë e bënë duke u ndarë në katër grupe dhe ja si i radhitën librat ato:

Gr. I. - i radhiti sipas asaj si i merrnin në dorë nga vendi ku ishin vendosur,

Gr. II. - i radhiti sipas madhësisë së librave,

Gr. III. - i radhiti sipas mbiemrit të autorit dhe fushës që i takojnë veprat, dhe

Gr. IV. - i radhiti sipas ngjyrave që kishin librat.

Pyetja: Cili nga grupet i radhiti si duhet librat?

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes.

Para dy ditësh Artës i vjen një letër ku i thuhet se ajo ishte një vajzë që do t'i besohej një rol në një film, i cili do të xhirohej muajin e ardhshëm. Ajo ishte vajza që ata kërkonin prej shumë kohësh, prandaj e lusnin që të mos e refuzonte ofertën që i bënin.

Në tekstin e dhënë, Artës i kërkonin të jetë:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë.

Një ditë Blertonit i tha gjyshi të shkonte në shitore dhe të sillte lajmet dhe informacionet më të reja që kishin dalë atë ditë. Blertoni mori paratë dhe shkoi. Kur arriti në shitore u kujtua se kishte harruar të pyeste gjyshin se çka ishte ajo gjë që i kishte ato lajme dhe informacione. Prandaj e pyeti shitësin.

Çështje ajo gjë që ka lajmet dhe informacionet më të reja të ditës?

Cila do të ishte përgjigjja e shitësit:

Lexo strofën e poezisë dhe pastaj përcakto çfarë bën poeti:

Ty atdhe

**Ty atdhe secili të do
si diellin, si ajrin
si ushqimin që ha**

si nënën si babanë.

Fjalja: Agimi luan bukur futboll, prandaj ai merr pjesë në ekipin kombëtar.

është fjali:

Lexo tekstin e poshtëshënuar dhe shëno për çfarë teksti bëhet fjalë?

E dashur Dritë,

Ka një javë që mendoj për ty dhe vajzën tënde të vogël. Do të doja të isha edhe unë pranë jush e të shihja se si më rritet mbesa, prandaj kam vendosur të vij së shpejti. Ardhja ime le të mbetet surprizë për ju.

Ju përqafoj me mall, gjyshja.

Lexo tekstin e poshtëshënuar dhe shëno për çka bëhet fjalë?

E dashur nënë,

Kaloi kohë e gjatë pa të parë ty, babin dhe vëllanë. Do të doja të isha edhe unë pranë jush dhe bashkë të festonim ditëlindjen time, por jam larg dhe e zënë me punë prandaj s'jam pranë jush. Shpresoj në ditëlindjen tënde të jemi bashkë.

Ju përqafo me mall, Shpresa.

Çfarë bën poeti kur përdor fjalë si në fjalitë e dhëna:

- Faqet si trëndafile.

-E sytë si rrush me vesë.

Pranë secilës përgjigje janë shënuar, dita, muaji dhe viti. Në cilin rast janë shënuar drejtë:

Në fjalinë: Luani i fortë vraponte si vetëtima.

Fjala, i fortë, është:

Lexo vargjet dhe përgjigju pyetjes

Livadhesh bari u kosit,
Këng' e gjinkallës të mërzit.
U ngritën çadrat në bregdet,
Koria, pylli na thërret.
Me manaferra buzët nxijmë,
Në uj', si rosat vapës rrijmë.

Cili nga titujt e dhënë i përshtatet?

Lexo vargjet e dhëna dhe përgjigju pyetjes

*Qielli është i qëruar,
I kulluar pors i ari,
I fjetur e i qetuar,
Syri s'nginjetë së pari.*

Çbën poeti në vargun:

"I kulluar pors i ari"

Çbën poeti kur përdor fjalë si në vargjet e dhëna:

- Dhëmbët si rruaza.

- Fjalët si mjalt i kulluar.

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Gjergji po bisedonte me Vjollcën dhe në një moment i thotë: Vjollca mbrëmë e kam parë një film vizatimor shumë interesant. Quhej "Trimëresha" dhe e di si ishte?! Princesha Merida e vendosur për të bërë rrugën e saj në jetë, kundërshton një zakon që sjell kaos në mbretërinë e saj. Merida duhet të mbështetet në trimërinë e saj dhe aftësitë e saj për të ndrequr harkun e një mallkimi që kishte zënë rrënjë në atë mbretëri. Kështu vazhdon dhe i tregon disa momente të filmit. Pas kësaj e porositi ta shohë edhe ajo.

Në tekstin e dhënë duket që Gjergji, Vjollcës i:

Në fjalinë: Ai po çmendej nga dhimbjet atë natë.

Folje është:

Lexo fjalitë e dhëna dhe përgjigju pyetjes

- Bledi luan tenis.

- Ai luan tenis.

Emri Bledi, në fjalinë e dytë është zëvendësuar me përemër :

Kryefjala e fjalisë së mëposhtme është:

Drita u fliste me ëmbëlsi shoqeve të saj.

Në fjalinë e dhënë gjeni foljen që është përdorur në kohën e ardhme? Vigani është i zgjuar, ai i adhuron kafshët, prandaj dhe do të bëhet veterinar.			
Fjalët: vajzë-gocë, parfem-livandë, janë:			
Fjalët: Rri-shko, dua-urrej, qesh-qaj, janë:			
Përemër vetor në fjalinë e dhënë është: Të gjithë shkuan në kamp, vetëm ne mbetëm aty për ta vazhduar lojën.			
Në fjalinë: Këta janë kundërshtarët e ekipit tonë. Fjala <i>këta</i> , është përemër:			
Në cilin grup të fjalëve të dhëna të gjitha janë emra:			
Kryefjala e fjalisë së mëposhtme është shprehur me: Ajo dëgjonte në heshtje tingujt e instrumentit.			
Në fjalinë e dhënë folje është: Ajo shkoi atje me shoqet e saj për një javë.			
Në fjalinë e dhënë emra të përveçëm janë: Dea dëshironte të lahej në lumin Drin, mirëpo nëna e saj nuk e lejonte, pasi ajo s'kishte mësuar ende notin.			
Në fjalinë: Era i tregoi së motrës sekretin e saj më të madh. Emri <i>motrës</i> , është përdorur në rasën:			
Bora është vajzë besnike, e zgjuar dhe e bukur. Sa mbiemra përmban fjalia:			
Fjalia e dhënë në vetvete përmban folje dhe emra. Sa janë ato: Arbi ka një kitarë, një piano dhe një daulle.			
Cili grup fjalësh të dhëna është formuar vetëm nga mbiemrat:			
Emrat: <i>zog, plak, gardh, lum</i> në numrin shumës, saktë të gjithë do të ishin:			
Fjalitë e dhëna më poshtë, përmbajnë edhe përemra. Cilët janë ato? Ne ishim lodhur aq shumë sa mezi prisnim të shkonim në shtëpi. Këta janë shokët e Arlindit.			
Të shkruarit e drejtë e të gjitha fjalëve të mëposhtme është nën: - fshatarsi, bashkëatdhetar, kurrëfarë, kokëulur.			
Në cilën fjali nga fjalitë e dhëna folja është përdorur në kohën e ardhme?			
Në fjalitë e dhëna përemra janë: Cili qe personi që na vizitoi mbrëmë? Me se kishte ardhur nga fshati?			
Cila nga datat është shkruar saktë:			
Analizo fjalinë e mëposhtme dhe përcakto gjymtyrët kryesore të saj? Butrinti gjendet afër qytetit të Sarandës.			
Në cilën nga fjalitë e dhëna, emri <i>zog</i> , është përdorur në trajtën e pashquar, rasën emërore, numrin njëjës:			
Fjalia e dhënë përmban fjalë të ndryshme. Në cilin rast përgjigja është e saktë nëse kërkohet sa prej tyre janë emra dhe sa mbiemra: Gjuetari i zgjuar, diti si ta zë dhelpërën dinake.			

Në fjalitë: Arta e dëgjonte gjyshin, kur tregonte historitë e tij interesante. Fjalët e tij për të ishin të arta. Fjala <i>arta</i> , është përdorur në forma të ndryshme. Cilat janë ato?			
Fjalja: <i>Gresa e pyeti gjyshen që t'i tregojë një përrallë.</i> Në ligjëratën e drejtë do të ishte:			
Lexo fjalinë e mëposhtme dhe përgjigju pyetjes: Beni kishte dalë në lëndinë dhe papritur aty kishte gjetur një çantë të mbushur me lodra të vogla, si: një kal, një veturë, rrotë, gomë, lepuj, ari, ujë, zogj dhe një gjel. Sa emra në numrin shumë të kjo fjali:			
Në fjalinë e dhënë, emra të gjinisë mashkullore janë: Lumenjtë ishin mbushur me ujë nga gjithë ai shi që ra dhe dukej sikur do të përpinin të gjithë rrugët, shtëpitë, njerëzit dhe gjithçka që u dilte përpara.			
Përemra në tekstin e mëposhtëm janë: Dukej sikur përtej malit do të vinte ai me shokë të shpëtonin vendin. Ata ishin të armatosur me pushkë në krahë si të malësorëve. Ne, vetëm shpresonim për mrekullinë që do të sillte ajo ditë.			
Fjalja e dhënë në ligjëratën e zhdrejtë do të ishte: <i>-Goni a i ke bërë sot detyrat?- pyeti Ardi</i>			
Cila nga fjalitë e dhëna është fjali e përbërë:			
Nga fjalitë e dhëna, fjali e thjeshtë është:			
Në cilën nga fjalitë e dhëna emri lule është përdorur në trajtën e shquar, rasën gjinore:			
Në fjalitë: - Heshtja përpiu të gjithë dhomën. - Hesht! –të lutem mos fol më! Fjalët heshtja dhe hesht janë:			
Mbiemra në fjalinë e dhënë janë: Liqeni i qetë dukej sikur kishte rënë në gjumë dhe do të ngrihej vetëm nga ndonjë dallgë e tërbuar.			
Në fjalinë e dhënë, fjalët <i>mësues</i> , <i>mësojmë</i> dhe <i>mësimin</i> janë: Mësuesi na tha të gjithëve që ta mësojmë mësimin, pastaj ta shpjegojmë dhe t'i shprehim paqartësitë.			
Lexo fjalinë e dhënë dhe gjeji foljet? Punëtorët punonin pa u ndalur dhe lodheshin aq shumë sa djersët u shkonin lum. Folje janë:			
Fjalët përbërëse të fjalisë së mëposhtme janë: Arta lexon roman.			
Në cilën grup fjalësh të gjita të dhënat janë shkruar drejtë:			
Fjalja e shkruar pa gabime drejtshkrimore është ajo në vijim:			
Përcakto çka paraqet secila fjalë në rendin e fjalëve në fjalinë e mëposhtme? <i>Struga është qytet shumë i bukur.</i>			
Fjalja: <i>Drita tha: "Lexoni poezitë e Agollit se janë të bukura"</i> , në ligjëratën e zhdrejtë do të ishte:			
Nga fjalitë e dhëna, fjali e përbërë është:			
Në fjalinë e dhënë, emrat e përdorur në trajtën e shquar janë: <i>Plaku shikonte me ëndje të gjithë ata djem, të cilët luanin vallen e lashtë popullore.</i>			

Në fjalinë e dhënë emri *libri*, është përdorur në trajtën dhe rasën e duhur. Cilat janë ato:
Ajo ishte historia e një libri të gjetur në bibliotekën e vjetër të qytetit.

Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju në pyetjen e dhënë.

Blerimi pasi kishte mbaruar me mësimet kishte shkuar me shokët të shohë ndeshje futboll. Ai kishte harruar se duhej të kthehej në shtëpi sa më parë, se do të shkonin në fejesën e djalit të dajës Bekimit. Prindërit u mërzhitën shumë pasi menduan mos i ka ndodhur diçka atij. Për fat të mirë ai u kujtua, dhe fillimisht ju telefonoi dhe pastaj menjëherë u nis për në shtëpi. Kur erdhi në shtëpi, ju sqaroi se si ndodhi dhe kërkoi edhe falje nga prindërit.

Pyetja: Si do ta përkufizonit historinë e Blerimit?

Lexo tekstin dhe pastaj përgjigju pyetjes:

Arbi mori një letër dhe filloi ta mbushë atë me fjalë aq të bukura, të cilat do t'ia dërgonte të motrës për t'ia uruar ditëlindjen.

Ana e ulur pranë kompjuterit lëvizte aq shpejtë gishtat në tastierë, thuajse do t'i nxirrte shkronjat një nga një. Era dëgjonte mësuesen që u diktonte një tekst të shkurtër dhe kujdesej që të mos gabonte në asnjë fjalë kur ta nxirrte në fletoren e sajë.

Çështë e përbashkët për Arbin, Anën dhe Erën?

Lexo tekstin dhe pastaj përcakto titullin që i përshtatet?

Ishte mëngjesi më i bukur i vitit, apo siç e quajtën fëmijët "mëngjesi i bardhë". Kudo që lëvizje nëpër lagje, ndihej hareja dhe lumturia e të gjithëve, e sidomos zëri i fëmijëve. Ata luanin dhe e ndjenin atë ditë, si ditën e dhuratës qiellore dhe në relaitet e tillë ishte, se vërtet e kishim marrë atë dhuratë. Natyra dukej si një fushë e mbjellë me re, e cila priste që të ledhatohej nga duart e fëmijëve dhe të ngrinin prej saj sa e sa krijesa të çuditshme.

Titulli do të ishte:

Lexo tekstin dhe pastaj përcakto titullin që i përshtatet?

Një ditë Zana mendohej për çudirat e botës. Ishin të shumta. Vetë natyra është një çudi, vetë njeriu është i tillë. Aq shumë fillojë të numërojë sa humbi në gjithë atë univers çudirash. Por zbulimet që kishte bërë njeriu ishin çudira në vete, e një nga më të mëdhat ishte, sipas saj, interneti. Ajo mendonte që internet është një superçudi pasi me anë të tijë ne mund të shetisim të gjithë botën, të lexojmë gjithçka që ndodh në tokë, të mësojmë gjëra nga më të ndyshmet. Për Zanën internet ishte një libër gjigant dhe për këtë ajo e konsideronte si përparimin më të madh që kishte bërë genia njerëzore.

Titulli i tekstit do të ishte:

Lexo tekstin dhe pastaj përcakto titullin që i përshtatet?

Një ditë Zana mendohej për çudirat e botës. Ishin të shumta. Vetë natyra është një çudi, vetë njeriu është i tillë. Aq shumë fillojë të numërojë sa humbi në gjithë atë univers çudirash. Por zbulimet që kishte bërë njeriu ishin çudira në vete, e një nga më të mëdhat ishte, sipas saj, interneti. Ajo mendonte që internet është një superçudi pasi me anë të tijë ne mund të shetisim të gjithë botën, të lexojmë gjithçka që ndodh në tokë, të mësojmë gjëra nga më të ndyshmet. Për Zanën internet ishte një libër gjigant dhe për këtë ajo e konsideronte si përparimin më të madh që kishte bërë genia njerëzore.

Titulli i tekstit do të ishte:

Tregoni si rimojnë vargjet e mëposhtme.

Hëna plot pesëmbëdhjetë
N'anët të qiellit po ndrin;
Bota është gjith' e qetë,
Gjësendi nuk përpin.

Qielli është i qëruar,
I kulluar pors i ari,
I fjetur e i qetuar,
Syri snginjet së pari.

Lexo vargjet e poezisë dhe përgjigju pyetjes.

Plot flutura të bardha
N'qiell fluturojnë,
Njëra-tjetrën ndjekin,
Pa pushim vallëzojnë.

Lulja del në oborr
Dhe pas tyre nxiton,
Do t'i prek me dorë,
Por veten mashtron.

Jo, ato s'janë flutura
Por fjolla të borës,
Shkrihen menjëherë
Në pëllëmbë të dorës.

Sipas vargjeve të mësipërme në poezi bëhet fjalë për:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes.

Ana qëndronte pranë dritares dhe mendonte: Borë Përsëri! Sa do të doja t'i mirrja
skitë ose sajën dhe të dal jashtë si gjithë fëmijët e tjerë. Por më kot! Ky grip nuk më lejon të bëj asgjë. Mirë e kishte gjyshja kur më thoshte të
vishem mirë, e unë nuk e dëgjova. Hë tani Anë, rri mbyllur! Pa ndale të afrohem afër zjarrit e t'i ngroh duart, se mos sëmurem me keq.

Teksti i dhënë është:

Lexo vargjet dhe përgjigju pyetjes

“Kush nuk e di Skënderbenë,
Që nderojti mëmëdhenë?...
Dhe sot nga armët e tija
Kullon thjeshtë trimërija!
E di njerëzi e tërë
Atë Zot ç'punë ka bërë:
“Kur hiq Skënderbeu shpatë,
Trimave u jepte datë!
Burra të veshur në hekur,
Dhe luftëtarë të pjekur,
Q'ishin në luftë kaluar
Përmbi kuaj të harbuar,
Kur hiq me kordhë të prehtë
Q'ishte si pendëz e lehtë,
Porsi pjeprin e priste,
Në vdekje pa ndjer i klliste,”

Vargjet e poezisë janë me motive:

Lexo vargjet e poezisë dhe përgjigju pyetjes .

Kopshtijeve kaloi puhia sugare
Dhe tundi hareshëm shaminë nën dritare...

“Mos na prek me duar të ngrohta, o erë!

- Lehtazi degët kanë shushuruar.
- Gjersa bora të shkrihet njëherë,
Nuk shkon mugulluar...”

Dhe bora shkrihet
Tretë.
Natyra gufon
Jetë...

... Sot në mëngjes
Sythi i parë,
I larë në vesë –
Diellin e puthin n'arë.

Vargjet e poezisë flasin për:

Lexo vargjet dhe përgjigju pyetjes

Gjithçka mund të sjellë dashuri,
Por më të madhen fëmijët.
Ata ia blerojnë syrin nënës.
Lules i shtohet bukuria
kur prek fëmija.
Zogut i rriten flatrat
kur e përshëndet fëmija,
pranvera i gëzohet çdo takimi me të,
vera i pjek frutet.
Yll më i bukur është fëmija –
në zemrën e nënës,
dita e merr dritën
nga sytë e tyre.

Fëmijët janë si zogj të rrallë,
Fëmijët janë si yje mëngjesit –
Janë këngë, gëzim e mall.

Vargjet e mësipërme i kushtohen:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes.

“Jetonte diku në një fshat të largët e të humbur një fshatar që e quanain Mitro. Ishte i varfër e i këputur dhe nuk kishte asnjë pëllëmbë tokë e asnjë kokë dhi. Sa u martua, u detyrua të lërë shtëpinë e nusen e re dhe të shkojë në kurbet. Aty do të bënte çdo lloj pune që të gjente, mjafton diçka për të mbajtur veten dhe të shoqen. Di të punonte për copën e bukës.”

Në fragmentin e dhënë trajtohet motivi:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes.

Vesa gjeti në oborr një mace të madhe të bardhë. Kishte mbyllur sytë nga dielli dhe ish shtrirë me plogështi.

- Paska mbetur vetëm? – e pyeti Vesa.
- Mijauuuu! – u përgjigj macja.
- Tani do të bëhesh macja jonë – tha Vesa.
- Macja mbylli sytë dhe fillojë të gërhasë.

Në tekstin e dhënë kemi:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Bekimi ishte djali më trim i lagjes, për këtë e donin dhe e respektonin të gjithë. Mirëpo një ditë Bekimi filloi ta teprojë me trimërinë e tij, duke e treguar atë edhe aty ku nuk kishte nevojë, kështu që trimëria mbeti vetëm një mburrje e tepruar. Bekimi tani nuk lejonte asnjë t’i dal përpara në lojë, nuk lejonte asnjë të luajë në lagje pa lejen e tij, se përndryshe ai i dënonte.

Kështu shokët një ditë u mblodhën të gjithë dhe vendosën që ta largonin Bekimin nga grupi, pasi ai ishte bërë tani një frikë për të gjithë. Bekimi mbeti i vetmuar për një kohë të gjatë, duke mos pasur pranë as edhe një shok. Vetmia i mësojë atij gabimin që kishte bërë, duke e kuptuar që mburrja e tepruar të bën dëm. Kështu Bekimi u kërkoi falje shokëve duke u premtuar se do të jetë më tolerant, paqësor dhe një fëmijë i mirëkuptueshëm.

Njëra nga arsyt pse shokët e larguan Bekimin nga grupi ishte:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Një ditë Betimi ju lut gjyshit të tij, i cili kishte qenë arkeolog, t’i tregojë një histori zbulimesh. Gjyshi duke ndjerë nostalgji për të shkuarën, i tregonte se si para 30 viteve, bashkë me shokët e tij të punës, kishin zbuluar në një fushë nën tokë, rrënojat e një kishë ilire. Ishte një kishë shumë e vjetër dhe brenda mureve të saj kishin gjetur edhe gjëra të tjera, si: mjete pune, enë, bizhuteri etj. Për gjyshin ky kishte qenë zbulimi më i madh në jetën e tij dhe edhe sot e kësaj dite mbetet si një nga kujtimet e tij më të bukura.

Bekimi e dëgjonte sy hapur dhe kënaqej e çuditej kur gjyshi fliste për të me aq dashuri dhe krenari, për këtë ai mori një fletore dhe fillojë ta shkruajë atë histori zbulimi që ta mbante kujtim gjithë jetën.

Duke u bazuar në tekstin e dhënë, Betimi e shkroi ngjarjen që i tregojë gjyshi sepse:

Lexo tekstin e dhënë dhe përgjigju pyetjes

- Shkoni të rrëshqisni! – na tha nëna. Mirëpo, ne u ulëm rreth gjyshes dhe shikonim.

- Ju doni diçka, apo jo? –na pyeti gjyshja.
 - Kam ftohtë – tha Ana dhe i tregoi duart e skuqura prej të ftohtit.
 - Edhe unë – u ankua Genti, e Dea përsëriti:
 - Edhe unë!
 - Do t'ju thur doreza – tha gjyshja dhe menjëherë vargoi nyjet nëpër kërrabëza. U afruam të gjithë dhe shikonim se si lëmshi i leshit po zhdërvillet e kërrabëzat po cingërojnë.
- Dhe kështu gjyshja na thuri dorezat. Të kaltra Gentit, të kuqe Anës e të larme Deës, prej fijeve që kishin mbetur, sepse leshi ishte sosur.

Përse fëmijët nuk dilnin të luajnë jashtë?

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Bredhi dhe ferra

Një ditë majë kodrës, bredhi i thotë ferrës:

- Më shiko mua! Unë jam i lartë, i forte, i hijshëm dhe mjaft i bukur. Ç'të mire ke ti? Je e vogël, e shëmtuar dhe shtrembaluqe.

Këto fjalë e mërzitën shumë ferrën, sepse e kuptoi se shoku kishte të drejtë.

Ditën tjetër, kodrës iu afruan disa druvarë. Ata filluan të prisnin bredhin. Donin ta përdornin për të ndërtuar një shtëpi të re.

- Oh, e dashur! – thirri bredhi ndërsa po binte. – Sa do të doja të isha një ferrë! Vetëm po të isha si ty njerëzit s'do të më kishin prerë.

Porosia (moral)i fabulës është:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

- I kujt është ky fustan Teutë?
- I nënës, sepse imi nuk më bën.
- Hi, hi, hi! – qeshën fëmijët – ka veshur fustanin e nënës!
- Edhe unë do të kisha dashur të kem fustanin tim, por jo të gjithë kanë mundësi të blejnë çdo ditë. – ua ktheu Teuta e pikëlluar.

Në tekstin e dhënë fjalët e autorit janë:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Agoni duke u menduar, i shkoi mendja të pyes Jetën për ndonjë film interesant që ajo kish parë.

- Jeta më trego ndonjë film që të ka pëlqyer shumë!
- Po tani – tha Jeta- unë pëlqej shumë filma, por po me vjen në mend historia e një vajze që quhej Sirsha, një vajzë e vogël e cila mund të shndërrohet në një fokë. Ajo fillon një aventurë me vëllanë e saj për të shpëtuar botën e shpirtave dhe qëniet e tjera magjike si ajo. Ishte shumë interesant.
- E si quhej ky film?- pyeti Agoni
- “Kënga e detit” – ia ktheu Jeta.

Në tekstin e dhënë kemi:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Një ditë Genta, bashkë me disa shokë dhe shoqe të klasës së pestë, morën pjesë në një emision për fëmijë. Aty flitej për dëshirat dhe problemet e fëmijëve në shoqërinë tonë. Njëri ndër mendimet që dha Genta lidhur me problemet e fëmijëve ishte:

“Ka shumë gjëra për të cilat njeriu duhet të luftojë në jetë, por së pari ai duhet të luftojë për të drejtat e veta. Edhe fëmijët kanë të drejtat e tyre. Shpesh prindërit dhe të rriturit e tjerë, kur ne fëmijët duam të bëjmë diçka ose të shprehim një mendim, thonë se “ju jeni fëmijë” dhe nuk na lejojnë të veprojmë. Prandaj ne duam t'u themi të rriturve që të jenë më të kujdesshëm dhe të na japin lirinë e fjalës!”

Sipas asaj që flitej në emision dhe mendimit që dha Genta, kuptojmë se kemi të bëjmë me motivin:

Lexo vargjet dhe përgjigju pyetjes

Rrëzë shkëmbit shekullor
Rrjedh i ftohtë si dëbor!
Aty lulet sapo zgjohen
Në pasqyrë shikohen.
Në burimin tone pini
Forcë dhe shëndet të kini.

Si rimojnë vargjet e poezise?

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Nxënësit e klasës së pestë, bashkë me mësuesen, një ditë vendosën të vizitojnë malin. Atje ata u mahnitën nga bukuritë e natyrës, nga fushat e gjera me lule, malet e shkëmbinjtë e mëdhenj, lisat e lartë, ajëri i pastër dhe gjithçka që ndodhej atje. Si mbaroi shtetja, para se të ikin në shtëpi, mësuesja u tha nxënësve që si detyrë shtëpie të përshkruajnë se si kishin kaluar atë ditë dhe ç'u kishte bërë përshtypje.

Pasi do të shkonin në shtëpi, nxënësit do të bënin:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Shpikja e celularit i atribuohet Martin Cooper, një nga inxhinierët më të mirë të shoqërisë Motorola. Martin prezantoi projektin për herë të parë më 3 prill 1973. Përkundër ambicieve të kompanisë, shpikja e re kishte ende shumë elemente që nuk bindnin. Vetëm pas 10 vjet përpjekjesh, projekti i celularit të parë arriti të zhvillohej deri në atë pikë sa të dilte në treg. Celulari i parë doli në shitje me një çmim rreth 4000 dollarësh.

Teksti i dhënë është:

Lexo pjesën të një bisede të një vajze me gjyshen e saj dhe pastaj përgjigju në pyetjen e dhënë.

- Kur janë moj gjyshe, lulet më të mira: në mëngjes, në mesditë apo në mbrëmje; natën apo ditën?
- Lulet? Cilat lule?
- Cilatdo. Edhe të kopshtit, edhe të livadhit, edhe...të gjitha.
- Lulet përherë janë të mira, moj bijë.

Këtë bisedë me gjyshen vajza j'ua tregoi shoqeve të klasës. Me këtë rast ajo ka bërë:

Lexo tekstin dhe përgjigju se çfarë teksti është:

“Hana e zbetë, si fytyra e nji të vdekuri, kundron nga kupa e qiellës. Kundron botën e maleve të kristalizueme nga bora. Kundron kasollat e kristalizueme të katundit, të cilat as frymë nuk marrin. Të gjitha janë mbështjellë në bardhsin e borës.”

Teksti i dhënë është tekst:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Donika bisedonte me Edonin dhe thoshte: Vitin e kaluar, bashkë me familjen time unë isha në qytetin e Gjirokastrës. E di Edon sa bukur ishte atje! Por edhe njerëzit ishin të mrekullueshëm. Ne dëshironin të vizitonim shtëpinë e shkrimtarit të madh Ismail Kadare, dhe ngaqë nuk mund ta gjenim pyetëm një grua plakë që rrintë në derën e shtëpisë së saj. Ajo jo vetëm që na shoqëroi deri te shtëpia e shkrimtarit, po fillojë të na rrëfejë ngjarje të ndryshme që lidheshin me të dhe me krejt lagjen. U kënaqëm shumë të gjithë!

Në tekstin e dhënë Donika:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Deri te: Kryetari i Komunës
I nderuar z.Kryetar,

Ne jemi nxënësit e klasës së pestë të shkollës fillore “Zef Serembe”.

Duke e parë që në shkollën tonë mungon një sallë sportive, ku ne do të mund të zhvillojmë jo vetëm aktivitetet sportive, por edhe aktivitete të tjera, ua drejtojmë këtë kërkesë me qëllim që të bëni diçka dhe të na mundësoni një gjë të tillë. Ju lutemi që të mirrni parasysh këtë kërkesë.

Me shumë respekt, nxënësit e klasës së pestë

Kjo letër drejtuar kryetarit, është:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

I dashur Lind,

Ka shumë kohë që po mendoj se si mund të kontaktoj me ty, por asesi nuk mund të gjej një mënyrë që të ta dëgjoj edhe zërin. E vetmja gjë që më ka mbetur nga ty është adresa që më le kur u largove nga lagjja.

Po të shkruaj numrin e telefonit që të më lajmërohesh kurdo që të kesh kohë: 046 – 567 789

Të fala familjes, Agroni

Teksti i dhënë është:

Lexo tekstin dhe trego cilit tip i takon sipas asaj se si është shkruar?

“E kur, andej nga mesnata, acarimi arrin dhe kulmin e vet, atëherë ndër bagëti fillon një lëvizje. Po, një lëvizje. Nji nga nji u aviten njerëzve e me syt e vet si me u lutë:” na lëshoni dhe neve të ngrofemi pak rreth zjarrit, se u ngrimë”. Dhe njerëzit kundrejt njerëzve s’kanë mëshirë, po kundrejt shtazëve -po. Prandaj çohen, ua lëshojnë bagëtis vendin rreth votrës, e ata vetë shkojnë n’errësinë që përpinë.”

Në tabelën e shpalljeve të shkollës ishte vendosur një shkrim si mëposht. Lexo tekstin e tij dhe trego çka tregon (paraqet) ai:

ShFK “Migjeni”

Me rastin e “7 Marsit” –Ditës së Mësuesit, shkolla jonë do të organizojë manifestim kulturor si vitet e mëparshme.

Të gjithë nxënësit, arsimtarët, punonjësit dhe prindërit janë të mirëpritur për ta festuar këtë ditë.

Programi festiv fillon në ora 11.00.

Këshilli organizativ,

Lexo tekstin dhe përcakto për çfarë tipi (lloji) të tekstit bëhet fjalë:

Vurkua: (Duke hyrë me rrëmbim):

Zenel, a erdhi Skëndo beu?

Zeneli:

Jo, zoti Vurko, po s'besoj të vonojë. Prit pakëz, në mos ke punë.

Vurkua: (Duke ndenjur.):

Do ta pres të vijë.

Adham-Uti : (Madhështor.):

Do të rri dhe pakëz, sido që kam punë shumë!

Vurkua: (Në vesh të Zenelit.):

Kush është ky?

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Dinozaurët ishin kafshë të mëdha kurrizore të cilët dominuan ekosistemet tokësore në një periudhë prej rreth 160 milion vjetësh, (rreth 230 milion vjet më parë) deri në fund të periudhës së shkumësit (65 milion vjet më parë), dinozaurët u zhdukën në periudhën e shkumësit - terciar.

Rreth 10.000 specie të shpendëve janë të klasifikuara si dinozaurë. Në gjysmën e parë të shekullit XX pjesa më e madhe e komunitetit shkencor dinte shumë pak mbi dinozaurët. Shumica e kërkimeve u filluan nga vitet 1970.

Teksti i dhënë është:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

Ana mbrëmë e kam parë filmin vizatimor “Narutoja i fundit” ishte shumë interesant. Motra e vogël e vajzës me emrin Hinata, është rrëmbyer nga një jashtëtokësor. Djali me emrin Naruto duhet të mbledh veten për të ndihmuar të dashurën e tij të re, që të gjej motrën e saj të vogël. Aftësitë e këtij djali vihen në provë kur ai humbet formën më të fuqishme- Sagën e 6 Shtigjeve.- tha Goni.

Çbën Goni në tekstin e dhënë:

Çfarë përshkruhet përmes kafshëve, shtazëve në përrallëza (fabula)?

Poezitë shkruhen në vargje. Nëse disa prej tyre formojnë një tërësi logjike atëherë themi se ato vargje formojnë:

Lexo pjesën e dhënë të një teksti dhe trego kur ndodh ngjarja?

Pasi që kishte një javë që kishte mbaruar viti shkollor, tek Arbnori erdhi gjyshi që ta marrë për të kaluar disa ditë pushimi në fshat. Arbnori i gëzuar përqafoji gjyshin dhe shpejt bëri gati teshat. Pas dy orësh u nisën për në fshat.

Lexo pjesën e dhënë të një teksti dhe përcakto çfarë tregon ai tekst?

“ Lexova një roman interesant për fëmijë! - i tha Lira, Albanit.

- Po ku e gjeje? – e pyeti Albani.

- Ma dha një shoqe e motrës sime. Ajo kishte një bibliotekë personale me shumë libra”.

Radhit fjalitë e dhëna sipas kronologjisë së ngjarjes?

1. Dje u realizuan gara komunale në Matematikë.
2. Fitues doli nxënësi i klasës sonë.
3. Në gara morën pjesë nxënës të klasëve të pesta.

Çka paraqet dekori në çfaqje?

Lexo tekstin e dhënë dhe përcakto për çfarë vendi bëhet fjalë?

Vendi është i qetë. Në të janë radhitur shumë libra të ndryshme, gazeta, revista ... sipas një rendi të caktuar. Aty janë të antarësuar të rritur dhe fëmijë dhe shpesh shkojnë dhe marrin diçka për të lexuar dhe pas një kohe përsëri e kthejnë aty.

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë?

Një grupi nxënësish të klasës së pestë iu dha për detyrë të përshkruajnë dhe përgatisin hapësirën ku do të realizohej çfaqja që kishin ushtruar më parë.

Çka duhet të përgatisin ato?

Gjatë realizimit të disa çfaqjeve teatrale ndodh që skena të pësojë ndryshime një ose më tepër herë.

Nga çka varet ndryshimi i skenës:

Arjeta dhe Arbnori kanë marrë detyrë të përzgjedhin dhe të bëjnë vizatimet për atë se si do të jenë kostumet (veshjet) që do të qepen për çfaqjen që do të realizohet në shkollë.

Çfarë duhet të kenë parasysh ato gjatë përzgjedhjes, kur të vizatojnë të kostumet?

Krijimeve të shkurtëra popullore përmes së cilave shprehet përvoja jetësore e njerëzve të moshuar e cila duhet t’u shërbejë si mësim gjeneratave të reja ju themi:

Fjalìa, – Kush i bën varrin shokut, bie vetë brenda. – është:

Përmbajtjen e një tregimi me pika të shkurtëra na tregon:

Cila nga fjalitë e dhëna është *Gjë e gjëzë*?

Mësuesja nxënësve të klasës së pestë iu dha të krijojnë nga një poezi, përmes së cilës do të kritikonin, përqeshnin të metat e një njeriu ose shoqërisë. Në këtë rast ajo ka kërkuar nga nxënësit të krijojnë poezi lirike:

Cilët vargje rimojnë ndërmjet tyre në strofën e dhënë?

Në mesin tuaj kam qëndruar
E jam duke u përvëlur
Që t’ju jap pakëz dritë
Natën t’jua bëj ditë

Radhiti fjalitë e dhëna me numra sipas kuptimit të ngjarjes?

1. Me këtë rast kemi ftuar shumë mysafirë.
2. Shkolla jonë sot feston ditëlindjen e saj.
3. Dëshira jonë është që të gjithë të mbeten të gëzuar.

Lexo tekstin e dhënë dhe përcakto për çfarë teksti bëhet fjalë?

- Babi sot takova një shoqe që quhej Selma Bajraktar.
- Cilën Selma?
- Atë shoqen që njoha në plazh.
- Pse Bajraktari e paska mbiemrin ajo?

- Jo Bajraktari po Bajraktar, tha Arta.
- Ou! Qeshi gjyshi – Bajraktari me Bajraktar janë larg.
 - E po mirë atëherë, e kemi kushërirë të largët. Hë gjysh!

Lexo vargjet e dhëna dhe përcakto se si rimojnë ndërmjet tyre?

Kur më shihni se jam tretur
Mos pandehni se kam vdekur
Jam i gjallë e jam në jetë
Jam në dritë të vërtetë
Unë jam në shpirtin tuaj

Mos më kini për të huaj

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes

“ Aty vinin shokët e shoqet e tij të fëmijërisë dhe u mësonte të fshehtat e botës dhe jetës. Pa vinin edhe pleq e plaka që ta dëgjonin e të mësonin prej tij. Dhe të gjithë e falenderonin:

- Ti na i hap sytë, o bir! – i thoshtin pleqtë.
- Sa na meson ti në një ditë, nuk e kemi mësuar në një muaj!- i thoshin të rinjtë.

Me të rinjtë e të rejat këndonte këngë të lashta të të parëve të tyre. Disa u binin çiftelive e disa kitarave, instrumente të reja që i kishin mësuar atë kohë.”

Në tekstin e dhënë fjalët e autorit nuk janë:

Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjes së dhënë

Teuta atë ditë iku nga shkolla me një buzëqeshje të papërshkruar. Duke mbajtur në dorë librin e marrë si shpërblim, ajo thirri sapo gjyshja e hapi derën:

- Gjyshe, ia dola! Zura vendin e parë në garat e matematikës!

Cilët fjalë nga teksti i dhënë nuk janë të autorit:

Lexo tekstin e dhënë dhe përcakto për çfarë lloj të tekstit bëhet fjalë?

- Kur m'i tha këto fjalë, më erdhi të qaj.
 - Ule kryet, - më tha.
 - Ula kryet deri te jastëku; mësuesi më puthi në flokë. Pastaj më tha:
 - Shko! - dhe e ktheu fytyrën nga muri.
- Fluturova shkallëve teposhtë, sepse kisha nevojë ta përqafoj nënën.